

VETERANI

GAZETË PERIODIKE. NR.12(390)

DHJETOR 2020 ÇMIMI: 30 LEKË

Kryeredaktor: Halil RAMA ; Zv/Kryeredaktor: Sakip Cami Email: veterani.obvl@yahoo.com / website: www.VETERANIOBVL.ORG

FESTAT



**76 VJETORI I ÇLIRIMIT
MYFIT
GUXHOLLI:
Të nderojmë
Heronjtë e Kombit**

FAQE 3

HISTORIA

**RRUGA E LAVDISHME E
BRIGADËS SË IV-t SULMUESE**



Kolonel Ing.Myfit GUXHOLLI

FAQE 2

IN MEMORIAM



**Gjystina (Flora)
Sata –Dishnica,
kontributi në
luftë i një gruaje
në “hije”**

Kolonel Myfit Guxholli*

Av.Halil RAMA*

FAQE 4

Pafajësia e ish kryeministrit Haradinaj vërtetoi bllofin e kurditur nga ata që më e pakta duan të përkëdhelin serbët

ASNJË GJYKATË NUK MUND TË BALTOSË LUFTËN HEROIKE TË POPULLIT KOSOVAR

PËR HALIL RAMËN DHE VEPRËN E TIJ

SHPENDI TOPOLLAJ

Qysh në vitin 1897, te Nr. 2 i “Albania” - s, beu aristokrat i letrave shqipe Faik Konica shkruante se: “Shumë duhet të punojmë ne shqiptarët, sot dhe për së shpejti; po më parë nga të gjitha, të shëndoshim dashurinë dhe vëllazërinë në mes tonë”. Ndofta kjo thënie përherë aktuale edhe sot e kësaj dite, ka qënë edhe kryefjala e punës të gjatë në gazetari e mikut tonë të çmuar Halil Rama, i cili asnjëherë nuk u tundua nga ajo shprehja (mundet me shaka), e Çurçillit se “Gazetaria është një profesion tepër interesant, por duhet të braktiset me kohë”.

Përfaqësues dinjitoz i vlerave të larta të di-branëve (që unë kolonjari kam pasur rastin t'i njoh mirë), si mençuria, bujaria, ndershmëria, thjeshtësia e atdhedashuria, ai me punën e tij të pareshtur, e renditi veten në pararojë të institutit të gazetarisë shqiptare. Jetoi dhe shkroi në kohën e mashtrimeve universale, sikurse shprehej Orëelli, ku duke thënë të vërtetën, bëje revolucion. Dhe ai e bëri këtë, jo thjesht se e ngjeu penën e tij në realitete, siç thoshin romakët, de visu, por se edhe e dinte shqetësimin e një mendjeje të ndritur si Sami Frashëri që thosh se: “Shumë shqiptarë janë çquarë e kanë treguar vetëhenë në dituri e në të tjera gjëra; po me këta të tjerë mburenë e jo Shqipëtarët e Shqipëria”. Si dje dhe sot, ai nuk ra në grackat e militantizmit të verbër që veç përçarjes, nuk sjell asgjë të mirë, por në urtësinë e tij, pa harruar atë porosinë e Tëeinit se “zhurma nuk provon asgjë, shpesh një pulë që ka bërë vetëm një vezë, kakarit sikur ka bërë një asteroid”, hulumtoi, shkroi dhe botoi për ngjarje e figura të shquara, me të cilat ne duhet të krenohemi duke ndjekur shembullin e tyre.

(Vijon në faqen 7)



Nga Shpendi Topollaj:

Mos vallë po të ishte gjallë, do çohet në Hagë edhe Heroi i Kosovës, Komandanti i UÇK - së Adem Jashari që i lindur në Prekaz, po atje u vra duke luftuar, së bashku me 56 pjesarë të tjerë të familjes së tij, shembull i rrallë dhe ndofta i vetmi në historinë botërore?! Sipas kësaj llogjike, duhet shpënë në gjyq edhe udhëheqja e NAT -s që urdhëroi bombardimin për 78 ditë me radhë të kryeqytetit serb. A nuk jemi para një paradoksi kështu?!

FAQE 3

CEREMONIA

Në mjediset e Ministrisë së Mbrojtjes u dhanë certifikatat nga zv/ministri Petro Koçi



**Shaban dhe Fetah
Cami, babë e bir
dëshmorë të
Atdheut**

FAQE 6

PËRKUJTIMORE

**Naim Frashëri dhe
At' Gjergj Fishta,
poetë kombëtarë të
pandarë**

Muharem Kamani

FAQE 10

RRËFIMI I MAN ARIFAJ

**Si u arrit çlirimi i
Iballës 76 vjet më
parë**

Xhemal MEÇI - Mjeshtër i Madh

FAQE 8

IN MEMORIAM

**NURI DRAGOJ,
LUFTËTAR I
SHQIPTARIZMIT**

Kadri Tarelli

FAQE 9

REPORTAZH

**VLERAT DHE
RESURSET E
ZONAVE BERISHË
DHE IBALLË**

Kol DEDAJ

FAQE 11

77-VJETORI

Më 28 dhjetor 1943 u formua një nga njësitë më të mëdha e të organizuara të luftës partizane

Rruga e lavdishme e Brigadës së IV-t Sulmuese



Kolonel Ing. Myfit GUXHOLLI*

Në qarkun e Korçës deri në dhjetor 1942 ishin formuar 18 çeta partizane, midis të cilave ajo e Mokrës (Pogradec), e Gorë-Oparit etj. Ndërsa nga tetori '42 deri në maj 1943 numri i çetave partizane u rrit akoma. Më vonë, me rritjen e numrit të forcave të kryengritjes së armatosur nga çetat u krijuan batalionet partizane si Batalioni i Mokrës, Gorës, Kolonjës, Rrëzes, Malit të Thatë, Batalioni "Shqiponja" etj.

Si rezultat i luftimeve të ashpra të këtyre batalioneve me forcat armike u realizua çlirimi i zonës malore të Qarkut të Korçës.

Vështirë të flisje për 235 ditë luftime apo 350 goditje që iu dhanë armikut, duke filluar që nga shtatori 1942.

Në gusht 1943 formohet njësi më e madhe luftarake e Ushtrisë Nacionalçlirimtare në Makrezë të Vithkuqit me partizane e partizanë nga të gjitha krahinat e Shqipërisë, me komandant Mehmet Shehun, komisar Tuk Jakovën dhe zv/komandant Tahir Kadarenë. Ndërsa, më 28 dhjetor 1943, me urdhër të Shtabit të Përgjithshëm formohet Brigada e IV-të Sulmuese. Në përbërje të saj ishin batalionet me përvojë luftarake, si "Hakmarra", "Reshit Çollaku", "Shqiponja", "Fuat Babani", batalioni Gorë-Opar si dhe "Rinia antifashiste dhe punëtore" nga qyteti i Korçës. Në fillim Brigada kishte 550 partizanë e kuadro të organizuar në katër batalione: batalioni 1 me komandant Zija Kambo, i 2-të me komandant Petrit Dumen, i 3-të me komandant Spiro Moisiu e komisar Vaskë Gjinson, i 4-ti me komisar Andrea Ziu. Intendent i Brigadës ishte Raqi Qirinxhi. Brigada IV Sulmuese, një repart i armatosur, me 265 luftime dhe operacionet e saj u konfirmua si një njësi luftarake e aftë për të kryer detyra akoma më të mëdha. Ajo u rreshtua në Divizionin e I-rë Sulmues, të cilit iu ngarkua një detyrë e rëndësishme, siç ishte kalimi në Shqipërinë e Mesme dhe të Veriut dhe çlirimi i tyre nga okupatori nazist e kolaboracionistët e tij. Faqe lavdie e trimërie tregoi Brigada e IV-të S në Operacionin armik të Dimrit 1943-1944. Ajo zhvilloi luftime të përgjakshme dhe shpërtheu rrethimin që nazistët gjermanë kishin përgatitur gjatë këtij operacioni. Luftimet u kryen në kompaktësi bashkëveprimi mes batalioneve të brigadës. Në një kohë që forcat armike mendonin të shkatërronin forcat partizane të saj dhe forcat e Beratit, Brigada e IV-të S, e drejtuar nga shtabi i saj me në krye komandant Nexhip Vinçani

• *Brigada IV S i dha atdheut 274 dëshmorë, ndërmjet tyre N/komandant i Brigadës Pano Xhamballi, Xhafer Cenko Lubonja, komandanti trim Riza Taçi etj; të cilët prehen të qetë në altarin e lirisë së atdheut. Vetëm në luftën për çlirimin e Tiranës ranë në fushën e nderit 98 partizanë. Brigada IV S në 321 ditë të jetës së saj ka përshkruar 2200 km rrugë (në këmbë, jo me makina) duke kryer 265 luftime e operacione dhe duke i shkaktuar armikut mbi 2000 të vrarë e 200 robër (shumë ushtarë gjermanë) si dhe dëme të mëdha materiale e armatime*

e komisar Pëllumb Dishnica çau rrethimin në Qafën e Becit, duke kaluar në zonën e Beratit.

Mbas çarjes së rrethimit, brigada u kompaktësua dhe për një muaj rresht, me luftime sulmuese dhe në bashkëveprim me batalionet "Hakmarra", "Shqiponja", "Reshit Çollaku", "Fuat Babani" e forcat sulmuese të fshatrave të qarkut çliroi shumë fshatra, duke filluar nga Arrëzi (Devoll), Malësia e Kolonjës, Vithkuqit, Gorë-Oparit, Shënepremte. Në pranverë, gjatë mësymjes pranverore, në bashkëpunim me batalionet "Reshit Çollaku" dhe dy batalione të Brigadës së I-rë S çlijuan Pogradecin dhe Rrëzën e tij, Starovë, Tushemisht, Hudënisht, Piskupat, Grabovë. Mbas gjithë këtyre sukseseve, Brigada mbledhet në Lozhan për të bërë bilancin e luftimeve në 9 maj 1944. Numri i partizanëve ishte shtuar. Gjatë muajit maj brigada çliroi fshatrat në fushën e Korçës, Rrëzës, Gor-Opar duke përfshirë dhe zonën e Mokrës, Pogradecit, Malit të Thatë, Pojan etj.

Gjatë Operacionit Armik të Qershorit 1944, batalionet e Brigadës IV S zhvilluan luftime të ashpra në Qafë Thanë me forcat e Divizionit malor gjerman. Luftime të ashpra u zhvilluan në Maliq, Grabovë, Ploçë, Guri i Kamjes, Krosnisht, Moçan, Osojë, Gjiniakas, Malin e Dusharit, Qafa e Gjarpërit, në Bitinckë e Bilisht.

Pra, kjo luftë nuk është e shkurtër. Plot 750 ditë luftime përballë rrezikut të jetës. Ushtria gjermane kishte vendosur të asgjësonte përfundimisht forcat partizane në qarkun e Korçës por nuk ia arriti, sepse Brig. IV e komanduar nga Nexhip Vinçani dhe Pëllumb Dishnica triumfoi me sukses. Në mbarim të luftimeve u organizua një ceremoni, në të cilën iu dorëzua flamuri luftarak Brigadës së IV. Duke marrë flamuri komandanti Nexhip Vinçani, pasi u përul dhe e puthi atë me lot në

sy, u betua para efektivit të Brigadës: "Betohe se do ta mbajmë me nder e lavdi këtë flamur edhe në momente më të rrezikshme, duke mos kursyer edhe jetën tonë!". Dhe në të vërtetë flamuri luftarak i Brigadës së IV u mbulua me lavdi, duke triumfuar në betejat luftarake me armikun në qarkun e Korçës, Elbasanit, Dibrës, Matit etj.

Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë NCÇI lëshoi Urdhrin, më 28 Maj 1944 për kalimin në Mësymjen e Përgjithshme. Brigada IV S, pasi kishte kaluar një rrugë të suksesshme luftarake dhe në çlirimin e një territori të madh në Qarkun e Korçës, u inkadrua në Divizionin I Sulmues të UANÇI. Gjatë luftimeve në përbërje të këtij divizioni (brigada IV dhe V) çliroi Qarrishtën, Zerqanin, Matin, Homesh-Sofraçan, Fushë Alie, Grevë, Melan, në kazermat e Dibrës, kundër forcave gjermane e kolaboracioniste në Mirditë; çliroi Peshkopinë etj. Në dy javët e fundit të shtatorit Brigada e IV-të S zhvilloi luftime brenda në Elbasan dhe organizoi disa prita në rrugën Librazhd-Elbasan-Qafë Kërrabë.

Nga krahinat e Shqipërisë së Mesme dhe të Veriut populli u bind për luftën e drejtë kundër okupatorit dhe veglave të tij; u rreshtuan në radhët e partizanëve deri 2000 veta. Midis tyre kishte dhe disa partizanë italianë dhe armenë, të cilët kishin hyrë në UANÇI mbas kapitullimit të Italisë në shtator 1943.

Brigada e IV S shkroi faqe faqe lavdie gjatë operacionit për çlirimin e Tiranës. Ajo, së bashku me Brigadën e I-rë S, Brigadën e VIII-të dhe Brigadën e XVII-të sulmoi në një rajon tepër të fortifikuar; duke filluar nga kodrat pranë Kombinatit Tekstil në veriperëndim të Tiranës, deri tek kodra e Kopilit (sot sanatoriumi- varret e dëshmorëve të kombit).

Po ashtu mori pjesë në luftime tek varrezat e dëshmorëve të kombit, në Pallatin e Brigadave, tek ish Kisha e Shën Prokopit (në veri të Liqenit Artificial, ish-kazermat e Shkumbinit (qyteti i nxënësve, brenda në qytet tek pal-




latet e Moskatit dhe të Shallvares dhe deri tek Banka).

Brigada IV S, në betejën historike të Mushqetas (duke filluar nga Qafë Kërraba-Mushqeta) luajti një rol të rëndësishëm në shpartallimin dhe asgjësimin e forcave të mëdha gjermane. Brigada e IV-të S në operacionet për çlirimin e Tiranës tregoi vlerat e saj si njësi luftarake e suksesshme dhe e denjë për emrin që mbante, duke përmbyshur me nder detyrat e ngarkuara.

Aftësitë e kuadrove, partizanëve e partizaneve spikatën si çlirimtarë të suksesshëm. Rruga luftarake e Brigadës IV S, trimëria, heroizmi i luftëtarëve të saj në luftë për çlirimin e vendit, janë sot një burim i madh frymëzimi për popullin dhe veçanërisht për brezin e ri.

Brigada IV S i dha atdheut 274 dëshmorë, ndërmjet tyre N/komandant i Brigadës Pano Xhamballi, Xhafer Cenko Lubonja, komandanti trim Riza Taçi etj; të cilët prehen të qetë në altarin e lirisë së atdheut. Vetëm në luftën për çlirimin e Tiranës ranë në fushën e nderit 98 partizanë. Brigada IV S në 321 ditë të jetës së saj ka përshkruar 2200 km rrugë (në këmbë, jo me makina) duke kryer 265 luftime e operacione dhe duke i shkaktuar armikut mbi 2000 të vrarë e 200 robër (shumë ushtarë gjermanë) si dhe dëme të mëdha materiale e armatime.

* *Kryetar i OBVL – Ish-partizan i Brig. IV S*



Partizane te Brigades IV

FESTAT

76 vjetori i çlirimit, festa nën masa kufizuese. Krerët e OBVL, homazhe pranë Monumentit “Nënë Shqipëri”

MYFIT GUXHOLLI: Të nderojmë Heronjtë e Kombit



76 vjetori i çlirimit e gjeti Shqipërinë përballë një armiku të padukshëm që po gjunjëzon gjithë botën, Covid-19.

Si çdo luftë që ka brenda shumë betejë ajo me coronavirus-in do të vijojë çdo ditë dhe rezultati do të duket nga shifrat e përditësimit nga Ministria e Shëndetësisë.

Por edhe në këto kushte shqiptarët kremtuan sakrificën e heronjve të kombit

të cilët për mbi pesë vite luftuan ndaj okupatorëve fashistë e më pas ato nazistë.

Organizimet shtetërore qenë të kufizuara për shkak të masave anti-covid, njësoj si një ditë më parë në festën e 108 vjetorit të shpalljes së pavarësisë.

Pavarësisht kufizimeve në organizimet festive, nderimet për heronjtë e kombit nuk munguan.

Në emër të kryesosë së Organizatës së Bashkuar të veteranëve të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare (OBVL), kryetari i kësaj organizate kolonel Myfit Guxholli dhe nënkryetarja Mira Ohri bënë homazhe dhe vendoën një kurorë me lule pranë Monumentit “Nënë Shqipëri”.

“Lufta Antifashiste Nacional Çlirimtare është epopeja më e lavdishme e popullit shqiptar në të gjithë shekujt! Për herë të parë populli shqiptar u organizua në këtë luftë, nga më të përgjakshmet në historinë e njerëzimit, duke krijuar Ushtrinë Heroike Nacional Çlirimtare! Për herë të parë në histori Shqipëria u bë pjesë e Koalicionit Botëror Antifashist në krah të fuqive të Medha si SHBA, Britania e Madhe dhe BRSS! Për herë të parë fuqitë e mëdha si SHBA dhe Britania e Madhe dërguan pranë Shtabit të Përgjithshëm të UNÇL-së, përfaqësuesit e vet, të cilët ndihmuan ushtrinë me armatime, municione, veshmbathje, ndërlidhje, ilaçe, etj. Ne jemi krenarë pasi e çliruam vendin nga pushtuesi nazifashist me forcat tona”, shprehet kolonel Guxholli në këtë ditë historike.

Në 76-vjetorin e çlirimit të Shqipërisë nga pushtuesit nazifashistë, presidenti Ilir Meta, kryeministri Edi Rama dhe kryetari i Kuvendit Gramoz Ruçi, kanë mbajtur homazhe në varrezat e Dëshmorëve. Në homazhe ishte i pranishëm edhe kryebashkiaku Erion Veliaj, ministrja e Mbrojtjes Olta Xhaçka dhe ministrja e Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin, Elisa Spiropali.

Kreu i shtetit Ilir Meta: 108 vite janë mjaftueshëm për ta bërë Shqipërinë si gjithë Europa

Flamuri, simboli ynë i shenjtë përbashkues

Presidenti i Republikës, Ilir Meta ka uruar shqiptarët në Ditën e Flamurit Kombëtar, Ditën e Pavarësisë së Shqipërisë. Në mesazhin e tij, Meta thekson se: “Gëzuar Ditën e Flamurit Kombëtar, Ditën e Pavarësisë së Shqipërisë! Të punojmë dhe angazhohemi çdo ditë për ta mbrojtur simbolin tonë të shenjtë dhe përbashkues, të valvitet krenar në këto troje, i pastër dhe i paprekur, njësoj si gjaku i derdhur për të, nga bijat e bijtë më të mirë të kombit. 108 vite janë mjaftueshëm për të dëshmuar pjekurinë dhe seriozitetin e një shteti modern, për përmbushjen pa vonesë të aspiratës popullore dhe misionit të nisur në 28 nëntor 1912, nga Ismail Bej Vlora dhe gjithë etërit e Pavarësisë, për ta bërë Shqipërinë si gjithë Europa.

Urime për 28 Nëntorin e Gjergj Kastrioti Skënderbeut, Ismail Qemalit dhe Isa Boletinit! Zoti e bekoftë Flamurin Kombëtar dhe shqiptarët kudo ndodhen!”, shkruan Presidenti i Republikës, Ilir Meta.

Populli shqiptar ka treguar se di të ngrihet mbi përçarjet dhe ata që duan të shterin forcat pozitive

Presidenti Meta: 29 nëntori është fakt historik! Qytetarët të marrin fatet e tyre në duar



Presidenti i Republikës SHT Z Ilir Meta, pas nderimeve pranë monumentit “Nëna Shqipëri” për Datën e Çlirimit dha një prononcim për mediat, duket folur edhe për debatin lidhur me datat.

Në fjalën e tij, kreu i shtetit u shpreh se nuk ka asnjë debat për datat, pasi për të është vetëm 29 nëntori për çlirimin. Thirrja e Presidentit, është që gjithë shqiptarët duhet të marrin fatin e tyre në dorë për ta bërë Shqipërinë një vend më të mirë. “Shqiptarët nuk e pranuam pushtimin, me qëndresën historike të Mujo Ulqinakut dhe shumë të tjerëve. E deri në ditën kur ushtria anti-fashiste shporri nga terrori i vendit tonë edhe forcat më të fundit pa ndihmën e fuqisë së kuqe. Dha kontribut edhe përtej kufijëve duke rritur prestigjin dhe kontributin në këtë luftë të madhe që bëri të mundur edhe mbojtjen e sovranitetit të Shqipërisë. Ne sot përkulemi me nderim para Qemal Stafës, Vojo Kushit, Margarita Tutulanit që dhanë jetën për të lënë Shqipërinë një shtet të lirë dhe të pavarur. Tutulani i shkruante të vëllait “pse na duhet atdheu”, kur të rritesh do ta kuptosh por na duhet që të jemi të lirë. Sot është më e lehtë duhet të ketë më shumë angazhim. Duhet të jetë e mundur që të gjithë ata që kanë ikur të kthehen”, tha kreu i shtetit.

Pyetje: A jemi të rritur politikisht për të dashur atdheun?

Presidenti Meta: Mendoj se populli shqiptar ka treguar se di të ngrihet mbi përçarjet dhe forcat që duan të shterin forcat pozitive. Jam optimist se shqiptarëve u duhet ndryshim. Do të marrin fatet në duar, nuk kanë nga të presin.

Demokratët ishin dje (28 Nëntor), kur do t'i jepet fund debatit për datën?

Presidenti Meta: Për mua nuk ka debat për datat, është e provuar dhe argumentuar nga histografia. Nuk ka asnjë përpjekje që unë të eklipsioj LANÇ. Një pjesë e madhe e udhëheqësve të kësaj lufte u persekutuan gjithashtu, kishin qëllime të kundërta nga pushteti. Absolutisht ka qënë luftë e jashtëzakonshme që shpëtoi Shqipërinë nga ndarja. Edhe sot ka ligje që fajësojnë Shqipërinë si një vend sulmues. Falë atij gjaku ne shpëtuan shtetin tonë dhe në këtë drejtim duhet të jemi mirënjohës për atë epope të jashtëzakonshme.

Ambasadorja Kim uron me vargjet e Naim Frashërit: Nderojmë Ditën e Çlirimit



Ambasada Amerikane ka uruar Shqipërinë me rastin e Ditës së Çlirimit me disa vargje të Naim Frashërit. Postimi ka vijuar më tej, ku është treguar se nëpërmjet këtyre vargjeve ambasada nderon këtë ditë të veçantë. “Me këto vargje frymëzuese nga poeti i madh Naim Frashëri, ne nderojmë Ditën e Çlirimit të Shqipërisë”, shprehet ambasadorja Kim.

O Atdhe! Më je i dashur sa më s'ka

Më je nënë, më je motër, më je vlla.

Nga ç'ka rrotull më i shtrenjti ti më je,

Je më i miri nga çdo gjë që ka ky dhë.

Naim Frashëri

IN MEMORIAM

Gjystina (Flora) Sata –Dishnica, kontributi në luftë i një gruaje në “hije”

Flora, historia tragjike e bashkëshortes së Dr.Ymer Dishnicës

Kolonel Myfit Guxholli*
Av.Halil RAMA*

Ajo mbeti dhe kujtohet gjithmonë me emrin “Flora”, ish – emri (Pseudonimi) i saj në kohën e Luftës Nacionalçlirimtare.

Quhej Gjystina Sata, Bijë e një familje qytetare shkodrane, me ndjenja të thella patriotike dhe me besim katolik. Kishte lindur në atë zonë, që në Shkodër quhej “Arra e Madhe”. Librat që në fëmijëri, ishin dashuria e saj e madhe. Pasionin për romanet, ajo e ruajti gjithë jetën, deri në moshën 90 - vjeçare.

Gjystina (Flora) Sata –Dishnica (1924 -2020), e rritur me edukatën e fortë katolike të familjes dhe shkollës së murgeshave, ishte ndër vajzat e para, që theu këtë traditë të trashëguar ndër breza dhe me dhimbje, u largua nga familja, që në moshën 16 - vjeçare, për t’ju bashkuar idealeve të lirisë së atdheut.

Shtysën e parë për përfshirjen e saj në lëvizjen e grupeve komuniste ia dha Qemal Stafa, i cili mbeti për të, personifikimi i njeriut më të pastër dhe më idealist, nga të gjithë sa ajo njohu në luftë. Në vdekjen e tij, ndonëse vetëm qindra metra larg, ajo ishte prezente. E qau dhimbshëm, po atë ditë-natë, në birucën ku e futën dhe e torturuan, menjëherë pasi i vunë prangat atje, në fushën e mbjellë me grurë, ku Ata po vraponin për t’ju ikur karabinierëve dhe ku shoku i saj i luftës dha shpirt. Per vdekjen e tij të komentuar, ajo ka dhënë vite më parë, intervistën e saj në TVsh, duke kujtuar me vërtetësi, çdo detaj të kësaj ngjarjeje.

Ndër katër vite lufte për çlirimin e atdheut, ajo qëndroi e burgosur rreth dy vite, në periudha të ndryshme, në dy burgje, në Korçë dhe Tiranë, nga të cilat edhe u arratis.

Kontributi i saj në luftë, që nga fillimet e deri në fund, ka qenë i veçantë, ashtu pa bujë e krisma, për vetë pozicionet që ajo ka pasur.

Gjystina (Flora) Sata –Dishnica banoi dhe punoi, pikërisht në shtëpinë ku ishte Arshiva sekrete e grupeve komuniste, shtypshkronja dhe një arsenal armësh.

Burgun e parë, e përjetoi në Tiranë, ku e kapën dhe e torturuan, menjëherë pas vrasjes së Qemalit. Pas arratisjes nga ky burg ajo doli në ilegalitet, duke përdorur pashaportën me emrin

Flora Panariti. Më pas qëndroi në qytetin e Korçës, duke vazhduar aktivitetin ilegal.

Në Korçë u arrestua përsëri dhe përjetoi burgun e dytë. Megjithatë nuk kish mbushur akoma 18 vjeç, duke mohuar identitetin e saj dhe duke insistuar që quhej Flora Panariti dhe jo Gjystina Sata, duroi torturën e urisë dhe etjes, si dhe torturat fizike, pa nxjerrë asnjë emër të shokëve apo dokumentave që i kërkohehin. U dënua me vdekje, në kohën kur akoma vendi ishte i pushtuar nga fashistët italianë, por një urdhër i Duçes, që ndalonte ekzekutimet nën moshën 18 vjeç, e shpëtoi. U arratis nga ky burg pas afro një viti, duke u hedhur me litar nga kati i tretë i godinës.

Në Helmës vazhdoi punën, në shifren sekrete të Shtabit të Përgjithshëm, ku u njoh edhe me shokun e saj të jetës, Dr. Ymer Dishnicën.

Në vitin 1944, në prag të çlirimit, ata martohen, ashtu me “rrobat e luftes”, duke



pasur bindjen që luftuan për të mirën e vendit të tyre. As mund ta mendonin, që do të përjetonin për dekada persekutimin dhe të cilësoheshin me termin “Armik te popullit”, pikërisht ata dy luftëtarë idealistë, të orëve të para.

Jeta e tyre, pas çlirimit ka kaluar nëpërmjet një sërë tallazesh, në të cilat, kjo grua, jo vetëm nuk iu nda për asnjë çast bashkëshortit dhe shokut të saj të luftës, por në periudha të veçanta, u përball me trimërinë që e karakterizonte edhe me persona shumë famëkeq të diktaturës.

Në vitin 1950, internohen në qytetin e Beratit, ku jetuan për rreth 44 vite. Ky qytet i vogël, i trajtoi me dashamirësi dhe respekt. Gjithsesi, tallazet shoqëroreshin edhe me periudha të qeta. Të dy si çift, me shpirtëgjërësinë, kulturën, humorin që i karakterizonte, shumë të kujdesshëm, edhe në atë liri aq të cunguar dhe të kon-

trolluar frikshëm nga diktatura, gjenin mundësinë të hapnin dyert e shtëpisë së tyre, për një rreth të gjerë shoqëror.

Një familje e konsoliduar, me tre fëmijë të respektuar, gjithashtu, prej të gjithëve, Perin, Kozetën dhe Tatjanën. Të dy këta prindër, të zhgënjyer nga idealet e tyre të fillimit, u përballën me shumë peripeci, për të edukuar si duhet fëmijet dhe për të mbrojtur familjen e tyre.

U rikthyen në Tiranë pas 44 vitesh, duke përjetuar më në fund, ditët e demokracisë. Ata bënë një jetë bashkëshortore, me një mirëkuptim dhe dashuri të tillë, që shumekush mund ta kish zili.

Gjystina (Flora) e mbështeti fuqimisht dr.Dishnicën në organizimin e drejtimin e Organizatës së Bashkuar të Veteranëve të Luftës (OBVL), nga krijimi i saj më 1994 e deri sa ndërroi jetë më 22.9.1998.

Ajo, si dhe fëmijët e saj ndjenë gëzim të

• Jeta e tyre, pas çlirimit ka kaluar nëpërmjet një sërë tallazesh, në të cilat, kjo grua, jo vetëm nuk iu nda për asnjë çast bashkëshortit dhe shokut të saj të luftës, por në periudha të veçanta, u përball me trimërinë që e karakterizonte edhe me persona shumë famëkeq të diktaturës

veçantë kur Dr.Ymer Dishnica u dekorua nga Presidenti i Republikës Bujar Nishani me Titullin “Nderi i Kombit”, më 28 Nëntor 2014.

Gjystina (Flora) ndërroi jetë, nga pleqëria, pa asnjë sëmundje, pikërisht në ditën e saj të lindjes, në moshën 96 – vjeçare, (më 7 nëntor 2020) pasi kishte kaluar një pleqëri të bardhë, nën kujdesin e tre fëmijëve të saj.

Ajo do të mbetet simbol i një nëne të perkushtuar, bashkeshortes besnike dhe i një “luftëtareje në hije”.

Gjystina Sata (Dishnica) për kontributin e saj në luftë, u vlerësua, nga Këshilli i Ministrave, në vitin 2004, me rastin e 60 vjetorit të çlirimit të atdheut, me Medaljen “Për kontribut të shquar në çlirimin e atdheut”, dhe më pas, me Medaljen e Mirënjohjes “Për kontribut të veçantë në luftë për mbrojtjen e vendit”, dhënë nga Ministria e Mbrojtjes,.

Kalvari i jetës së saj, në luftë dhe në diktaturë, nuk mund të përmbledhet në faqen e një artikulli. Ai meriton të shkruhet në librin e jetës së saj.

**Kolonel në pension & Kryetar i OBVL-së
Mjeshtër i Madh & Sekretar i Përgjithshëm i OBVL-së

Homazh për autorin e 14 librave studimor e shkencor për Malësinë e Gjakovës

Ibrahim Kadri Malaj, “Qytetar Nderi” i Malësisë Tropojane

Nga Isuf IMERAJ

Familja, të afërmit, miqtë dhe shokët e shumë, përcollën për në banesën e fundit me të gjitha nderimet që Ai i meritonte, intelektualin, studjuesin dhe veprimtarin e palodhur shoqëror Ibrahim Kadri Malaj. Ai u nda nga jeta fund-tetorin e këtij viti në moshën 88 vjeçare.

Ibrahim Kadri Malaj ka lindur në fshatin Tpla të Tropojës në një familje atdhetare.

I etur për arsimim e dije, kreu shkëlqyeshëm të gjitha nivelet e shkollimit, deri tek diplomimi “agronom i lartë”. Dijet e përfutuara në shkollë i implementoi suksesshëm në praktikë, si një specialist shumë i aftë në sektorin e bujqësisë e blegtorisë.

Përkushtimi ndaj punës dhe niveli shkencor në kryerjen e detyrave bënë që ai të ngjitej në karrierën e tij, nga specialist i thjeshtë deri shef i Seksionit të Bujqësisë në rrethin e Tropojës. Falë nivelit të lartë shkencor dhe akademik ai i dha krahinës së Tropojës përparësi në zhvillimin ekonomik.

Ibrahim Kadri Malaj e rriti profilin e tij intelektual e krijues edhe si studjues e shkrimtar, duke lënë për publikun 14 libra të botuar me autorësinë e tij. Në këto libra studimorë ai ka pasqyruar me vërtetësi e profesionalizëm historikun zhvillimor të Tropojës në shekuj, që në kohën e Dardanisë ilire ku bente pjesë edhe Tropoja. Kështu mund të përmendim librat e tij voluminozë: “Malësia e Gjakovës-Tropoja”, “Tropoja ime”, “Tropoja në breza”, Traditat etnokulturore”, “Bujqësia e blegtoria tropojane”, etj.

Kushdo që ka patur fatin të lexojë këto libra ka njohur nga afër vlerat e këtij shkrimtari si studjues, hulumtues e historian i mirëfilltë.

Është për t’u vlerësuar fakti që 14 librat e tij, Ibrahim i ka shkruar dhe botuar pasi ka dalë në pension. Në këtë kontribut studimor dhe shkencor të tij, padyshim që është edhe mbështetja e familjes: katër djemve dhe tri vajzave, të edukuara e diplomuara në nivelet më të larta arsimore. Ai ndjehet krenarë



me fëmijët që kanë krijuar familje solide, si pasardhës të prindërve të nderuar Malaj. Për këto merita dhe vlerat e tij të spikatura njerëzore, intelektuale e krijuese, Tropoja e ka shpallur Ibrahim Kadri-në “Qytetar Nderi”.

REAGIM

Pafajësia e ish kryeministrit Haradinaj vërtetoi bllofin e kurditur nga ata që më e pakta duan të përkëdhelin serbët

• **Mos vallë po të ishte gjallë, do çohet në Hagë edhe Heroi i Kosovës, Komandanti i UÇK - së Adem Jashari që i lindur në Prekaz, po atje u vra duke luftuar, së bashku me 56 pjesarë të tjerë të familjes së tij, shembull i rrallë dhe ndofta i vetmi në historinë botërore?!**

• **Sipas kësaj llogjike, duhet shpënë në gjyq edhe udhëheqja e NATO - s që urdhëroi bombardimin për 78 ditë me radhë të kryeqytetit serb. A nuk jemi para një paradoksi kështu?!**

SHPENDI TOPOLLAJ

Farsa e gjyqeve ndaj drejtuesve kryesorë të UÇK - së dhe vetë Kosovës së Pavarur, edhe pas më shumë se 20 vjetësh, fatkeqsisht vazhdon; madje ka hyrë në një fazë të turpshme. Qëllimi për ta baltosur luftën e ndershme të djemve dhe vajzave të Kosovës, tashmë është mëse i qartë. Duhet të jesh i verbër, i përlur ose fare pa tru që të mos kuptosh se çfarë loje po luhet kundër një populli që u bë viktimë e një politike shfarosëse, nisur qysh nga famëkeqi Milosh Obrenoviç, të "Naçertania" e Ilija Garashaninit, Pashçit, Nikollës, "Dëbimi i shqiptarëve" i të poshtrit akademik Vasa Çubriloviç, emisarëve titistë Mugoša me shokë, gjatë Luftës Nacional - Çlirimtare, Rankoviçit e deri të gjenocidi i falangave kriminale të drejtuar nga kasapi i Ballkanit S. Millosheviç me mashat e tij të tipit Zhelko Raznatoviç Arkani. Është e tepërt të kujtohet tmerret e përbindshme që ushtria serbe shkaktoi mbi një popull të shtypur, të çarmatosur, të pafajshëm e të vuajtur. Ato nuk i kemi me të treguar e me të dëgjuar, por me mundësitë që ka krijuar modernizimi sot, i kemi parë vetë, siç i pa bota mbarë bota që nuk donte ta besonte se pirgjet me kufoma të hitlerianëve do përsëriteshin sërish, gjersa lindi rezistenca heroike ndaj asaj dhune të pashpirt dhe bashkimi me të i vepërimeve luftarake të forcave të NATO - s. Shqiptarët kudo që janë, ashtu sikurse i kanë mbetur mirënjohës përjetë, gjithkujt që ka thënë edhe një fjalë të vetme në favor të çështjes tonë kombëtare, nuk do të harrojnë kurrë kontributin e asaj Aleance për vendosjen e drejtësisë njerëzore dhe juridike. Është fakt i pamohueshëm, se Pavarësia e Kosovës erdhi edhe si rezultat i ndërhyrjes ushtarake të tyre dhe përpjekjet e ndërkombëtareve për ndërtimin e një shteti demokratik ishin mëse të do-



ASNJË GJYKATË NUK MUND TË BALTOSË LUFTËN HEROIKE TË POPULLIT KOSOVAR

mosdoshme. Por, në kontekstin e këtyre ngjarjeve, disa të vërteta duhen thënë hapur, pa pasur kompleksin se mos keqkuptohemi. Edhe pse e dimë se politikë e shteteve të fuqishme, lëvizin sipas koniukturave të krijuara dhe interesave afatgjatë, sikurse u shpreh i nderuari President Bill Clinton, është disi e pa justifikuar pyetja e drejtuesve serbë, se a duan ta njohin pavarësinë e Kosovës. Vështirë të gjendet një rast i ngjashëm në praktikën botërore që agresori me duart ljer me gjakun e burrave, grave, fëmijëve e pleqve të një populli paqësor që jetonte në trojet e veta shekullore, pra xhelati dhe viktimë të ulen në të njëjtën tavolinë dhe të zhvillojnë bisedime. A s'të kujton kjo xhelatin që i thoshte Don Karlosit se "Të vras për të mirën tënde"? Askush nuk e shpejtoi dot se për çfarë arsyesh Kosova, me të mbaruar lufta, nuk u orientua nga bashkimi i natyrshëm me shtetin amë. A e dinë të huajt se kosovarëve u digjet shpirti për Shqipërinë aqsa edhe fëmijët e tyre i quatin me emrat e qyteteve shqiptare. A nuk ishin ata që shprehën admirim për bujarinë e pashembullt me të cilën ne i pritëm vëllezërit e motrat tona të përzëna nga tanket, topat e mortajet e ushtrisë serbe? Ç'e keqe i erdhi botës nga bashkimi i dy Gjermanive? Cili është ai ligj në të drejtën ndërkombëtare që pengon bashkimin, kur atë e dëshërojnë vetë popujt? Po vendosja e stërzgjatur dypushtetit në

nxjerrja në gjyq si terroristë e krerëve të luftës më të ligjshme të kohëve moderne, personaliteteve më të larta të shtetit të Kosovës, arrestime që qartazi shfaqin qëllimin e ulët për të përdhosur imazhin e një lufte mëse të drejtë. Shqiptarët e Kosovës nuk u ftuan në dasmë nga ana e qeveritarëve të Beogradit. Ata kur u sulmuan, reaguan sipas ligjeve të luftës, ku vepron llogjika që po më qëllonë do të të qëllon të të vras. Ata nuk shkuan në Serbi dhe nuk bënë kurrfarë gjenocidi atje, se fundja nuk e kishin as fuqinë e duhur përpara makinerisë ushtarake serbe, që mbështetej moralisht dhe ushtarakisht nga një superfuqi e njohur siç ishte Rusia. Çfarë do bënin ndërkombëtarët, sikur dikush t'i sulmonte vendet e tyre me zjarr e me hekur, t'u digjte qytetet e fshatrat, të shkatërronte objektet historike, kulturore dhe të kultit, të vrste kë të gjente, të përdhunonte gratë dhe vajzat e tyre apo t'i vinte përpara siç bënin dikur hordhitë e Xhingis Hanit? Mos vallë po të ishte gjallë, do çohet në Hagë edhe Heroi i Kosovës, Komandanti i UÇK - së Adem Jashari që i lindur në Prekaz, po atje u vra duke luftuar, së bashku me 56 pjesarë të tjerë të familjes së tij, shembull i rrallë dhe ndofta i vetmi në historinë botërore. Kujtoni Gjyqin e Nurembergut të zhvilluar nga 20 Nëntori i 1945 deri në 1 Tetor të vitit pasues, dhe nuk do gjeni asnjë nga gjeneralët e ushtrive fituese që të gjykohej për shkelje të rregullave të luftës, se do të qe gjëja më e pa drejtë dhe më e pakuptimtë. A nuk ishin vallë avionët e RAF - it dhe të tjerëve që bombarduan qytete gjermane dhe vranë me mijra nga popullsia civile. Nuk e nxori kush Pol Sibiersin në gjyq pse hodhi bombën e parë atomike në 6 gusht mbi Hiroshima duke vrarë dhjetra mijëra qytetarë, që u pasua nga ajo e tre ditëve më vonë në Nagasaki. Dhe ai gjyqi i Nurembergut mbetet në historinë e jurisprudencës si gjyqi i parë model i aplikuar nga një Tribunal Ndërkombëtar, shembulli i të cilit duhej ndjekur nga legjislacioni i OKB - së. Besoj se në Hagë e dinë shumë mirë këtë. Po ashtu, nuk ka sesi shpjegohet i gjithë ky zell, veçse si një shkelje e parimit të gjësë së gjykuar, pasi ka rënë me kohë akuza bazë, ajo e fantazmës së asaj shtëpisë së verdhë misterioze. Po ashtu, pafajësia e ish kryeministrit trim Haradinaj e vërtetoi bllofin e kurditur nga ata që më e pakta duan të përkëdhelin serbët. Po pse ka shkuar puna deri këtu? Mendja

ta do të besosh se në mes është futur politika e cila arsyeton se "Kosovën e kemi tonën, makinerinë luftarake serbe e gjunjëzuam. Tani na mbetet ta afrojmë, dhe të mos ja lemë influencës ruse. Ata muslimanët (!) e Kosovës, mjaft e kanë aq sa kanë fituar". Sipas kësaj llogjike, duhet shpënë në gjyq edhe udhëheqja e NATO - s që urdhëroi bombardimin për 78 ditë me radhë të kryeqytetit serb. A nuk jemi para një paradoksi kështu. Platoni qysh në kohën e tij e quante drejtësinë si "harmoninë e virtyteve të maturisë, guximit dhe urtësisë". Por a po tregohet e tillë ajo gjykatë me drejtuesit e djeshëm dhe të sotëm të Kosovës. E kanë thënë edhe të tjerë para meje se çfarë drejtësie është ajo që vepron me dy standarde; pra kur merret me këmbëngulje me udhëheqësit e Kosovës që bënë luftë çlirimtare dhe i lë të patrazuar ata si Aleksandar Vuçiçi që ishte Gebelsi i Millosheviçit. Po si është e mundur kjo, kur dihet se janë po ata që turbulluan gjithë Ballkanin dhe u morën jetën qindra mijra njerëzve. Dhe ja tani, në këtë klimë, pas akuzave që nuk i janë bërë as Geringut e Himlerit, serviret marrëveshje me Serbinë. Po si mund ta besosh këtë pa buzëqeshur hidhur? Le ta themi hapur; në shqiptarët, si këtu, si në Kosovë, nuk kemi asgjë me popullin serb. Por politikën nuk e bëjnë ata, por qeveria. Dhe qeveria serbe vështirë se e ka seriozisht përmirësimin e marrëdhënieve me Kosovën. Si e tillë, ajo punon nën rrogë, jo vetëm që Kosova të mos njihet nga shtetet e tjera, por edhe të krijohet ideja se ata jo që s'kinë të formojnë shtet, por edhe janë kriminelë, nga ata të rrezikshmit që bëjnë krime jo dosido, por kundër njerëzimit. Pra, të vërtetohen teoritë djallëzore të "akademikëve" të saj. Para këtij realiteti, nuk është shumë dinjitoz edhe qëndrimi i politikës tonë të jashtme. Dikush mund të preket nga këto fjalë, por ky është mendimi im edhe pse e di që Volterit thoshte se "Është e rrezikshme të kesh të drejtë, kur qeveria është gabim".

Nëqoftëse historinë e kanë përcaktuar si jehonë e së shkuarës në të ardhmen, po u garantoj se nuk kanë për t'u bërë ndonjëherë miq të vërtetë me ne serbët. por, kjo është puna e tyre. Neve na takon që të ngremë fort zërin për padrejtësitë që po bën drejtësia e Hagës me një problem mjaft madhor tonin. Fundja edhe ne kemi Akademi Shkencash. Heshtja është e pafalshme.



CEREMONIA

Në mjediset e Ministrisë së Mbrojtjes u dhanë certifikatat nga zv/ministri Petro Koçi

Shaban dhe Fetah Cami, babë e bir dëshmorë të Atdheut

Në mjediset e Ministrisë së Mbrojtjes para disa ditësh u dhanë certifikatat e shpalljes së dëshmorëve të Atdheut Shaban Mahmud Cami dhe Fetah Shaban Cami nga fshati Viçisht i Dibrës.

Në ceremoninë e dorzimit të certifikatave të dëshmorëve ndodhej Zv/ministri i Mbrojtjes Petro Koçi, drejtori i Muzeut të FARSH Dr. Asllan Zemani, kryetari i Shoqatës së historianëve ushtarakë Prof. Dr. Bernard Zotaj, etj.

Në emër të familjes Cami certifikatat i mori në dorë zonja Tefta Cami, e cila falenderoi Ministrinë e Mbrojtjes për angazhimin dhe interesimin e saj për statusin e dëshmorëve të Atdheut.

SHABAN MAHMUT CAMI (1832-1918)

Luftëtar i shquar për gjuhën shqipe dhe për çështjen kombëtare.




Dëshmor i Atdheut, Shpallur me Vendim të Komitetit Ekzekutiv të K.P. të rrethit Dibër nr. 72 datë 24.05.1978. Rishpallur nga Ministria e Mbrojtjes në nëntor të vitit 2020.

Shaban Mahmud Cami është lindur më 1832 në Golevisht, lagje e Viçishtit të Dibrës. Ai u rrit në një familje patriotike dhe në një fis të madh me tradita.

Shabani ishte anëtar i klubit patriotik "Bashkimi" në Dibër të Madhe që në formimin e tij në vitin 1908. Shkonte në këmbë nga Golevishti në Dibër të Madhe në mbledhje dhe aktivitete patriotike.

Prof. Mahmud Hysa tek Vepra "Studime 6" f. 289, duke ju referuar kujti-



meve të Haki Stërmillit "Dibra në prag të historisë" na jep pothuajse listën e plotë

të anëtarëve të këtij klubi patriotik që drejtohet nga Sherif Langu, ku nga fisi Cami, krahas Eqeremit, Danit dhe Shahinit ishte edhe Shaban Cami nga Golevishti (Viçisht).

Babai i Shabanit, Mahmuti, kishte marrë pjesë në luftën kundër pushtuesve turq të komanduar nga Hajredin Pasha në Fushën e Gjoricës në korrik të vitit 1844.

Tek Shabani vinin shumë miq e shokë si Sulë Shehu, Mersim Dema, Elez Isufi, Dan Cami etj., që përfaqësonin nandë malet e Dibrës në atë kohë.

Në vitin 1909, në mbledhjen e Qafës së Çerenecit u bë grupimi i forcave kundër turqve me në krye Shaban Camin, Dalip Danin e Hazis Xhekën nga Gjorica. Turqit u hakmorën. Plagosën Shaban Camin duke i bërë atentat, dogjën shtëpitë e Hazis Xhekës dhe

kapën të gjallë dhe varën Hazis Xhekën dhe Dalip Danin në Dibër të Madhe.

Në vitin 1918 serbët intensifikuan veprimet në kufi si dhe masakrat e popullsisë civile. Studiuesi Prof. Gazmend Shpuza shkruan se shtëpitë e fisit Cami u bënë preja e parë e armikut duke u djegur tërësisht.

Në vitin 1918 serbët e vranë dhe masakruan Shabanin dhe e hodhën te Përroi i Viçishtit. Dy vjet më parë forcat bullgare dhe ato serbe vranë të birin e Shabanin, komandantin e çetës Fetah Shaban Camin.

FETA SHABAN CAMI (1875-1916)

Dëshmor i Atdheut, Shpallur me Vendim të Komitetit Ekzekutiv të K.P. të rrethit Dibër nr. 72 datë 24.05.1978. Rishpallur nga Ministria e Mbrojtjes në nëntor të vitit 2020.

HOMAZH PER AKADEMIKUN E SHQUAR KOSOVAR

Organizata e Vetteranëve të LANÇ të Kosovës njoftoi se më 12 Nëntor 2020, në moshën 89-vjeçare ndërroi jetë akademik Ekrem Murtezai.

Akademik Ekrem Murtezai lindi në Gjakovë, ku kreu shkollën fillore dhe mori mësim në Medresenë e Madhe të Gjakovës.

Në vitin 1948 u regjistrua në Shkollën Normale të Gjakovës, ndërsa në vitin 1951 u diplomua në Pejë. Studioi për filozofi në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Beogradit. Pas studimeve deri në fund të viteve '60 punoi mësimdhënës në shkollën normale dhe në gjimnazin e Gjakovës, ku ishte edhe drejtor.

Nga viti 1969 e deri në vitin 1973 ishte në detyrën e këshilltarit të pavarur në Byronë Ekzekutive të Komitetit Qendror të Lidhje Komuniste të Jugosllavisë (LKJ) dhe një-

kohësisht edhe shef i kabinetit të Fadil Hoxhës, i cili në atë kohë ishte anëtar i Byrosë Ekzekutive. Ndërkohë mbaroi studimet pasuniversitare për politikologji në Fakultetin e Shkencave Politike në Beograd. Në vitin 1973 u zgjodh ligjërues i lëndëve historia e filozofisë antike dhe mesjetare dhe filozofisë marksiste në katedrën filozofi-sociologji në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës (UP), ku më 1977 mbrojti edhe tezën e disertacionit të doktoratës me titull "Lenini për logjikën dialektike".

Ishte profesor i rregullt i lëndëve të lartpërmendura gjatë viteve 1983-1991, por edhe i disa lëndëve të tjera filozofike: estetikë, logjikë, filozofi klasike gjermane, filozofi bashkëkohore etj. Për një kohë ligjërroi edhe metodologjinë dhe teknikat e kërkimeve shkencore në degën e gjuhës dhe të letërsisë shqipe. Gjatë viteve

1973-1981 ishte drejtor i Qendrës Krahinore të Arsimit Marksist. Kreu edhe detyra të tjera në institucionet e arsimit.

Anëtar korrespondent i Akademisë së Shkencave dhe i Arteve të Kosovës u zgjodh në vitin 1996, kurse në vitin 2000 u zgjodh anëtar i rregullt. E. Murtezai është autor i disa librave nga fusha e filozofisë, i artikujve shkencorë, i fjalorëve terminologjikë, i librave shkollorë: "Filozofia materialiste-dialektike" (1975), "Studime filozofike" (1975), "Stalinizmi dhe neostalinizmi" (1976), "Pikëpamja e Leninit për metodën dialektike" (1976), Marksizmi, socializmi dhe vetëqeverisja" (1981), "Disa terma aktualë politikë" (1986), "Fjalori i filozofisë" (1995), "Fjalori i feve" (2000), "Hyrje konceptuale në filozofi" (2015) etj.

Për shkak të rrethanave të pande-



misë, në ambientet e Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës u mbajt mbledhje komemorativë me familjarët dhe anëtarët e Akademisë.

SPECIALE

Dhjetra personalitete të letrave e të shkencës, në promovimin e librit të shkrimtarit e gazetarit të dekoruar me Titullin “Mjeshtër i Madh”

60-vjetori i ditëlindjes, Presidenti Meta në promovimin e librit të 17-të të Halil Ramës

AGRON SEJAMINI

Promovimi i librit “Muhurri, histori dhe personalitete” të shkrimtarit dhe publicistit Halil Rama – Mjeshtër i Madh”, organizuar nga OBVL, Shoqata “Bashkësia Dibrane” dhe Botimet “M&B”ka bërë bashkë personalitete të njohura të jetës publike dhe politike të vendit. Në këtë veprimtari promovuese, mes dhjetra personaliteteve të letrave e të shkencës, i pranishëm ishte edhe Presidenti i Republikës, SHT Z. Ilir Meta, i cili në fjalën e tij përshëndetëse tha se libra të tillë na sjellin ndërmend vlerat e atdheut tonë.

“Ndër të tjera në këtë libër më bëri përshtypje titulli ‘Atdheu fillon nga familja’. Pikërisht kjo duhet kuptuar drejt dhe edukimi atdhetar duhet nisur me dashurinë për familjen”,-tha kreu i shtetit. Presidenti Meta, duke përshëndetur pjesëmarrësit në këtë veprimtari promovuese mbresëlënëse, vlerësoi krijimtarinë e Halil Ramës, si një prej produkteve dhe cilësore. “Ashtu si vetë autori Halil Rama, edhe personazhet që ai përshkruan në këtë libër, me mençuri kanë ditur të adaptojnë qëndrime dhe sjellje në përputhje me rrethanat e kohës, duke përzgjedhur qëndrim perspektiv e duke u bërë të dobishëm e me vlera kombëtare dhe shoqërore”, tha kreu i shtetit. Në këtë kontekst ai veçoi monografinë kushtuar filozofit popullor dibran Dine Hoxha, këtij




kolosi të mendimit, i njohur si këshilltari më i afërt i Mbretit Ahmet Zogu, por edhe si organizator i rezistencës popullore dibrane kundër pushtuesit serb, para një shekulli në mars - shtator 1920.

Në këtë promovim të moderuar me mjeshtri të rrallë nga Defrim Methasani, pasi ndoqën dokumentarin e ideuar dhe realizuar prej tij me titullin sinjifikativ: “HALIL RAMA – MJESHTËR I MADH, NË

60 VJETORIN E LINDJES”, folën disa personalitete krijuese dibrane dhe kombëtare, si Prof.Bujar Kapexhiu, redaktorja Luljeta Prençi-Dishi, kolonel Myfit Guxholli, gazetarja Klodiana Lala, dr.Hajri Mandri, Shpendi Topollaj, Dr. Asllan Zemani, drejtor i Muzeut të Forcave te Armatosura, administratori i “Botime M&B” Bujar Karoshi, etj.

(Vijon në fq.12)



GUXHOLLI:
Atdhedashuria, lajtmotiv në krijimtarinë e H.Ramës

Kryetari i OBVL, kolonel Ing.Myfit Guxholli, në përshëndetjen në emër të kësaj organizate veçoi dy kapituj të këtij libri: “Muhurri në Nëntë Malet e Dibrës” dhe “Kontributi i muhur-rakëve në Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare. Pikërisht nisur nga evidentimi i patriotizmit të popullit të kësaj krahine në luftat për liri e pavarësi, klonel Guxholli vlerësoi mesazhin e atdhedashurisë që përcjell autori H.Rama nëpërmjet këtij libri tek brezat e sotëm e të ardhshëm. Ndërkohë ai vlerësoi qëndrimin e Presidentit Meta për promovimin e vlerave më të mira të kombit tonë dhe veçanërisht dekorimin prej tij të heronjve e dëshmorëve të kombit.



Kapexhiu: Përkushtim, seriozitet, dinjitet, dashuri për vendlindjen

Kryetari i Shoqatës “Bashkësia Dibrane, Prof.Bujar Kapexhiu – Nderi i Kombit, duke përshëndetur në emër të kësaj Shoqate, ndër të tjera tha se shkrimtarë si Halil Rama që shkruajnë për vendlindjen e tyre duhet të ketë më shumë vendi ynë. Edhe në këtë libër, -tha Kapexhiu, autori shfaq përkushtim, seriozitet, dinjitet, dashuri, mall, respekt, mburrje, nostalgji, krenari, e të gjitha së bashku këto

ndjesi, si një gjerdan gurësh të çmuar në gjoksin e Halil Ramës, japin shkëlqimin dhe meritën e të suksesshmit që çdokush e çmon dhe e vlerëson këtë punë, pasi ky autor, duke mbledhur germë pas germe, ashtu siç milingona punon, ka ngritur me pasion këtë kështjellë kryelartë, të pakrahasueshme të Muhurrit. Ai e vlerësoi librin “Muhurri, histori dhe personalitete” si një privilegj për muhur-rakët, se kudo, në çdo cep të botës që të jenë do të kenë pranë vetes malet, fushat, lumin, lulet, shtëpitë, komshinjtë, familjen e gjithë të njohurit e dashur e të shtrenjtë të vendlindjes, për të mos i harruar kurrë. Kjo sipas tij për faktin se në faqet e këtij libri, midis rreshtave, si në një pasqyrë, çdo muhurak do të shohë veten dhe do të arrijë në përfundimin se në këtë pasqyrë të krijuar nga mendja dhe dora e Halilit duket më i mirë, më trim, më punëtor, më i bukur e më i mençur.

Shoqata “Labëria”: Libër i shkruar me dashuri dhe fisnikëri për vendlindjen

Dr. Asllan Zemani, drejtor i Muzeut te Forcave te Armatosura, duke përshëndetur në emër të kryesisë së Shoqatës Kulturore Atdhetare “Labëria” - “Nderi kombit”, dega Tiranë, tha se libri i Halil Ramës ka për mision në kohën e sotme, që për të për dymbëdhjetë katundet e kësaj zone, me histori njëjtë të pasur, ta ruaj atë në shoqërinë e integruar, kur po sakrifikohen shumë e shpesh pa të drejtë nga indentiteti ynë i spikatur, nga traditat, zakonet dhe njerëzit që kanë bërë histori, sepse njerëzit janë larguar nga fshatrat për të gjetur botën e Re. “Libri është shkruar me dashuri dhe fisnikëri për krahinën, për Muhurrin, vendlindjen e autorit, zonë e përmendur në historinë e vjetër dhe të re të Dibrës. Këtë libër, edhe ne të shoqatës “Labëria” e vlerësojmë si një pasuri të vyer, por edhe si një nevojë të fuqishme shpirtërore, për të ruajtur e transmetuar në breza vlerat dhe virtytet më të mira të të parëve tanë, por dhe të



brezave tonë. Në këto kushte e me këtë synim, në parktikën e punës së shoqatës, është të mbajë lidhje e bashkëpunim vëllazëror me të gjithë fshatat e krahinës, apo edhe me trevën e Dibrës, duke zbatuar misionin fisnik, me vullnet të lirë, para vendlindjes dhe të parëve tanë, vjen libri i Halil Ramës që brezit të ri të mos i mungojë vendlindja, historia e familjes, e fisit, të mos u mungojnë varret e të parëve, xhamitë, dasmat dhe ritet tradicionale tepër të pasura”,-tha ndër të tjera Dr. Zemani.

PËR HALIL RAMËN DHE VEPRËN E TIJ

SHPENDI TOPOLLAJ

(Vijon nga fq.1)

Mjaft të kujtoj se vetëm koha pas vitit 2003, pra qysh kur ai drejtonte gazetën “Veterani”, organ i OBVL, ka qënë mëse e mjaftueshme për të evidentuar jo vetëm aftësitë e tij profesionale, jo vetëm formimin e tij intelektual, por edhe shpirtin e tij të madh, ku mbi të gjitha spikat mirësia dhe dëshira për bashkim. Askush nuk mund të gjejë në faqet e asaj gazete asnjë rresht denigrues, provokativ a përçarës, gjë e rrallë kjo në shtypin tonë. Problemi kombëtar, me të cilin veç Akademisë tonë, duhej të merreshin akoma më dukshëm edhe politikanët, në këtë gazetë ka gjetur hapësirën dhe trajtimin e duhur, të drejtë e të guximshëm. Tashmë nga kushdo dihet fakti se shumë kuadro të para çlirimt, të luftës e të punës, u denigruan, u burgosën, u internuan familjarisht dhe u pushkatuan nga diktatura, dhe si nga politika ashtu edhe nga organet e shtypit, vazhdojnë të lihen në harresë, duke harruar njëkohësisht se Brehti e kishite quajtur fatkeq atë vend që nuk ka heronj. Dhe a nuk flet qartë edhe intuita e pagabueshme e Nderit të Kombit, gjeneral lejtant Rrahman Parllakut të ndjerë që e orientoi ta mbante pranë si birin e vet Halil Ramën? Po ashtu, është për t’u përshëndetur edhe vlerësimi që ju bë atij nga ana e Presidentit të Republikës, duke i akorduar këtij autori të shumë librave, titullin “Mjeshtër i Madh”. Gjej rastin të kujtoj se ndokush që përpigjet ta ndalë dorën e atij që Kushtetuta i ka dhënë tagrin e dekorimeve, po gabon rëndë. Shqipëria ka pafund njerëz të mrekullueshëm që kanë dhënë e vazhdojnë të japin për Atdhe. Qysh para 24 shekujsh krijuesi i shkollës së Çinikëve Antisteni, nxënësi i filozofëve Gorgias e Platon, thosh se “Shtetet shkatërrohen atëherë, kur nuk mund të dallo-



jnë të rëndësishmit nga të parëndësishmit”. Mirë ngurrojmë t’i shpiem të lightë në gjyqe, po pse trembemi t’u japim të mirëve atë që meritojnë. Në vitin 2005, nobelistja Svetlana Aleksandrova Aleksieviç është shprehur: “Jeta njerëzore bëhej histori dhe historia copëzohej në mijëra jetë njerëzish”. Këtë bën pa u ndierë edhe miku ynë Halil Rama, sikurse do ta gjeni edhe te ky libri i tij i ri “MUHURRI, histori dhe personalitete”.

Libra si ky i Halilit, janë edhe si një thirrje për të kthyer vëmendjen nga vendi e historia jonë e lavdishme, se u lodhëm duke parë me lutje e përgjërëm nga të huajt, edhe pse e kuptojmë haptazi se ata po luajnë me ne dhe me të ardhmen tonë. Dhe pasi ta lexoni atë do të shihni edhe njëherë se ai është një gazetar dhe shkrimtar që vepron si një nxënës i Lukianit, teksa i “thur laudi tokës që rrit djem petrita”, duke mbetur kështu i denjë për atë thënien e Euripidit se “Profeti më i mirë është ai që predikon të mirën”.

HISTORIA

SIPAS RRËFIMIT TË VETERANIT NGA IBALLA E PUKËS, MAN AVDI ARIFAJ

Si u arrit çlirimi i Iballës 76 vjet më parë

Xhemal MEÇI - Mjeshtër i Madh

Më 4 gusht 1983 shkova në Iballë të kulla e veteranit Man Avdi Arifaj, i cili më mirëpriti buzagaz e me bujari. Më pas, si një intelektual i mirënjohur popullor, më pyeti se ç'e mira më kishte çue tek Ai. I tregova se, duke përfutur nga pushimet vjetore si arsimtar i shkollave verore, po hulumtoja për traditat e Pukës, prandaj në këtë vazhde pune erdha edhe në kullën Tuaj të shquar. Si e kishte zakon, duke më shikuar me dashamirësi, m'u përgjigj qetë-qetë se zor se mund të më ndihmonte për ndonjë gjë me rëndësi. Por për sa më tregoi, unë mbeta i kënaqur prej Tij. Pak nga pak mora mjaftë të dhëna për fisin e Thaçit dhe Buç Gjeçin nga e ka prejardhjen ky si familje e vëllazëria e Tij, Buçajt e Iballës dhe brezat e ti deri te Buçajt. Gjithashtu më tregoi me entuziazëm për Lidhjet martesore që kishte si familje, duke i ndej besnik shprehjes popullore fisnore se "Martesa e mirë të lartëson, ndërsa martesa e keqe, me familje jo soj e jo fisnore të sharron. Prandaj, lum miku, matu ku merr e ku jep!"

Por, së parit i kërkoja të më tregonte se si u çlirua Iballa në mënyrë paqësore nga partizanët e Brigadës VI e XXII Sulmuese më 6 Nëntor 1944.

Për vete Mani rezervohet të fliste, sidomos për bujarinë e vet dhe të të parëve të tij. Mendohej të shmangej, se i dukej se po lavdërohej, gjë që nuk e pëlqente nga modestia e vet. Por pak nga pak ia nxirja fjalën e duhur. Kështu edhe për pritjen e partizanëve të Brigadës VI e XXII-S. Këtu u ndal më shumë, se kishte për të theksuar se "Lufta e viteve 1939 - 1944 - tha - na mësoi se si të ishim sa ma të kujdesshëm që të mos groposeshim një ditë. Brigada VI-S kishte ndejt dy ditë në Qerret, ku kishte zgjedhë Këshillin NÇL (me kryetar Kadri Kasemin dhe sekretar Idriz Met Dema, anëtar Këshilli (edhe Qazim Nushin, hoxhën e fshatit) dhe në vazhdim së bashku me shumë partizanë Qerretas, si: Ali Bytyçi, Nezir Ismaili, Zenel Çoba, Xhemal Duga, Rexh Mehmeti, Shaban Toska, Islam Pema, Shaban Tafilaku, Isa Met Dema, Kapllan Çoba, Idriz Kadri Kasemi, Sadik Cena, Grosh Halili, Muhe Murat Musa, Selim Djaloshi, Ismail Avdi Shkreli (Dedaj) etj. dhe kishte vazhduar po kështu nëpër Dedaj, Bushat e Midhë pa has në asnjë pengesë apo sulm të forcave të milicisë nazifashiste, që kryesisht ishin strukë në qytetin e Pukës. Ndërsa, Ajo po i afrohej e sigurt Iballës, ku pritej se mos Mirakajt do të bënin një rezistencë, si ajo e Bjeshkës së Gojanit, Kodërbollash, ku pësuar disfatë.

Në ndihmë të saj ishte nisë prej Kryeziu edhe Brigada tjetër partizane XXII-S. Ishte me rrezik që të bëhej një sulm partizanë me vrasje e djegëje, qoftë edhe një krismë pushke po të dëgjohej ndokund Iballës. Por duke e ditur terrorin komunist që do të lëshohej egërsisht mbi Iballë, Kolë Bibë Mirakaj, duke e parë se brigadat partizane po i afroreshin edhe Iballës pa rezistencë kapiten Xhemal Laçi ishte larguar në heshtje, kurse kapiten Ymer Bardhosh Laçi dhe kapiten Pashk Curri me çetat e tyre ishin bashkuar me kohë me Qarkorin e Shkodrës, si edhe Zef Miraka, i cili mori dy mushka me armatim, municion te dyqani i Urës Berdhet dhe ua kishte çuar partizanëve të Br. XXII-S në Shkozë. Prandaj të ndodhur në këtë situatë, e kishte porositë Pashkun, të vëllanë, që me përkrahësit e vet të largohej në Rajë e Nikaj -Mertur përtej Drinit, për të mos u dhënë rast terrori mbi Iballë. Në këto kushte dhe Man Avdia bashkë me të kushërinin, Arif Hasanin, një i

ri aktiv e guximtar bisedojnë me Mal Jahun, kushërinin e Tyre, i lidhur me shokë të Çetës "Bajram Curri" të Tropo-

jës: po kështu me Mehmet Ramën, e të cilit ishin në lidhje me hallen e vet Nanë Shotën në Pukë dhe Gani Pukën, dajën, në njisitin gueril Shkodër. Për më tepër Hamzë Mehmeti pat shkuar me forcat partizane deri në Sanxhak, Jugosllavi, ku u shqua për trimëri si antinazifashist i guximshëm. Po kështu u lidhën me Mal Bajram Sokolin dhe sidomos me të bijtë, Bajram Malën dhe Tahir Malën të dalluar për gjallëri e qëndrim antinazifashist, familje- bazë e rëndësishme e LANÇL në Iballë e me lidhje me Çetën "Bajram Curri" të Tropojës. Gjithashtu me Demush Salihin, derë zotnish, por i ri aktiv." Si u morën vesh ndër veti, iu drejtuen edhe Mustaf Agës së Iballës, babai i të cilit, Zenel Aga që mbështetja e Bajram Currit në Iballë e viset e Pukës dhe një nga udhëheqësit aktiv të Kryengritjes kundër Gjonturqve (Turqit e Rinj), 1912. Prandaj, Mustafë Aga u tregua i gatshëm që t'u printe burrave e të rinjve antinazifashistë të Iballës. Mustafë Aga, për më tepër kishte dëgjuar se edhe Riza agë Kryeziu me Nuh Elëz Dervishin, Dom Mazrrekun, priftin e fshatit; Ndue Dedë Alinë, Nikollë Rrapin dhe Ramë Sherif Vesel Agën dhe me dhjetra Kryezias të tjerë i dolën përpara në Qafë-Arrë, mesvendi midis Qafë-Malit - Kryeziut Brigadës partizane XXII-S dhe i uruan komandantit të saj Sali VERDHA mirëseardhjen në Kryeziun patriotik, duke e strehuar bashkë me Shtabin e Tij partizan në kullën e Riza Mustafë Agë Kryeziu, të cilin me këtë akt historik për Kryeziun dhe Pukën e zgjodhën Kryetar të Këshillit LNACÇL për Kryeziun, kurse Nuhinë Kryetar i Frontit NACÇL për zonën Kryezi-Qafë-Mali. Kështu tue njoftue njani - tjetrin, mbas Cafë Agës, Mehmet Ramës, Mal Bajram Sokolit, Mal Jahës, Zef Mirakës, Gjokë Nikollës, Mark Zef Pematit, Pjetër Prendit etj. sa u bënë nja 70 vetë të veshur si për festë për t' i pritur partizanët me mirëseardhje, "me bukë e krypë e zemër!, si e ka zakon Malësia" që të shpëtonin Iballen prej shkatërrimit të sulmit partizanë me terror, si në Mirditë, Dibër etj.

"Ali Bytyçin e vuen në dijeni, i cili, i shoqëruar prej Nezir Ismail Djaloshit e shumë qerretasve të tjerë, e miratoi me gëzim këtë mikëpritje historike të Iballësve. Në Qarrami, në hyrje të Iballës u dukën ballëpërballë partizanët dhe iballasit. Këto të fundit, për të hequr dyshimin ishin veshur si për festë. Tuj u afrue Caf Aga thirri me të madhe: "O o o! Mirësevini në Iballë partizanë trima të Ali Bytyçit, bre!"

Jaho Gjoliq, 60-vjeçar, Komandanti i Brig. VI-S, iu drejtua Ali Bytyçit: "Urime Ali Bytyçi! Kjo qenka Iballa e vërtetë dhe jo Iballa "e reaksionarëve", siç na kishin ardhë lajme keqdashës, për me na armiqtësuar me këto burra e këtë rini trimash Iballas mikpritës e bujar! Prandaj të takojnë Urimet edhe ty, Ali Bytyçi, partizani ynë i nderuar i Pukës!" Ndërsa, Iballasve iu drejtua me fjalët: "Ju falënderoj në emër të të gjithë partizanëve të kësaj brigade, se prej kohësh s'e kam ndier veten kaq të gëzuar, se sa sot mes jush, që na nderuat me përsëritjen dhe ftesën Tuaj kaq bujare e burrërore!" (Simbas kujtimeve të partizanit Nezir Ismail Djaloshi, Qerret, 1969 me rastin e hartimit të Historikut të rrethit Pukë. (Për Jaho Gjoliqun, jetën dhe veprimtarinë e Tij, 1885- 1969; mund të shihet Fjalori Enciklopedik Shqiptar, Tiranë, 2008, f. 855-856).

Me kaq Iballa doli e fituar dhe e pazuar. Këtë akt patriotik Mani me të drejtë ia dedikonte Iballasve antifashist, kurse vetë Ai sikur s' kishte bërë gjë veç detyrës si Iballas. Me kalimin e kohës, kjo ngjarje historike, duket se qëllimisht u la disi në hije, se Mehmet Rama u shpall kulak për hakmarrje personale, Caf Aga, doli se kishte




Nezir Ismaili



Jaho Xholiku

qenë toger rezervë i xhandarmërisë së Zogut, Nezir Djaloshi, sado familje Dëshmor i Atdheut, filloi të shihej disi si mik krushqie me Niman Avdi Furrikun, familje bajraktari. Ndërsa Man Avdi Sejda ishte larguar nga Seksioni i Financës së Komitetit Ekzekutiv të Rrethit Pukë, ku pat punuar me përkushtim, ndershmëri dhe transparencë, gjë që nuk u pëlqeu burokratëve, prandaj dha dorëheqjen; Kurse Ali Bytyçi, Dëshmor i Atdheut, që do të dëshmonte si duhet, kishte vdekur, sado që i kishte lënë kujtimet në ditarët e Tij, që tani do të ishin një pasuri historike muzeale, por fatkeqësisht kishin rënë në një dorë djallëzore e cila i kishte futur diku, ku të mos gjindeshin më. Po ja ku erdhi rasti që të dilte përgjithësisht e vërteta e pritjes së partizanëve në Iballë e Kryezi, për "çlirimin" e Tyre paqësor, gjë që në të ardhmen, sigurisht që do të dalin kjo e vërtetë më e plotë dhe e vlerësuar pa subjektivizma. Mbas këtij "Çlirimi të Iballës" për t' u mbajt mend si shembull, filloi të zhvillohej ashpër, sikudo "lufta e klasave". Edhe Man Avdia u la në hije, por ai ishte njeri me karakter të forte e burrëror, i cili edhe pse i moshuar punoi pa u lodhur në punë krahuri. Deri në fabrikën e betonit në hidrocentralin e Fierzës, derisa kur doli në pension.

"I ndjeri Man Avdia, si i kujdesshëm që ishte me të gjithë, ma ka lënë edhe mua një porosi mjaft domethënëse! "Xhemal, ti ke marrë përsipër një detyrë



Man Avdia



Vali Verdha

Ish komandant i Br. XXII të Pezës më 20 Nëntor 1944 çliroi Pukën



Busti i Ali Bytyçit

Dëshmor i Atdheut - 1918 -1945

me rëndësi për Pukën me këto shkrime, por vepro si ai mihatori i mirë i arës së misrit, kur prashitë arën, i cili gjatë prashitjes i shkul me kujdes filizat e misërit të pazhvilluar mirë, dhe mandej filizin e mirë e mbush me dhe, që të rritet i shëndetshtëm. Kështu duhet të veprosh edhe ti me shkrimet e tua si ky mihatori i kujdesshëm që të thonë mandej: "bravo të qoftë, Xhemal Meçi!"

"Por kujdes veten e familjen, se më ka thanë Beqiri, im bir, se ti në

(Vijon në faqen 9)

IN MEMORIAM

NURI DRAGOJ, LUFTËTAR I SHQIPTARIZMIT

Kadri Tarelli

Nuk kam ndërmend të shkruaj jetëshkrimin e mikut tonë Nuri Dragoj, por po sjell në kujtesë dy raste, që i quaj fatlume dhe të magjishme, sepse nuk përsëritën më:

a. Korrik 2017. Me makinën e Nuriut që e ngiste vetë, u rehatuam edhe tre shokë: Viron Kona, Bashkim Saliasi dhe unë, që udhëtuam nga Tirana drejt qytetit Bajram Curri, me rastin e paraqitjes së librit “Thesari Kombëtar. 7-8”, botuar nga “Lidhja e Shkrimtarëve dhe Artistëve shqiptar “Papa Klementi XI. Albani”, që vepron në Suedi. Veprimtaria u organizua në mjediset e Muzeut Historik të qytetit, nga Klubi i Shkrimtarëve dhe Artistëve, të Tropojës, i drejtuar nga z. Lulzim Logu. Patëm një pritje tejet miqësore.

Këtë ngjarje që e pasqyrova në një shkrim me titull: “Thesari kombëtar” vjen në Tropojë”, ku përmenda: “Të pranishmit e mirëpritën dhe vlerësuan vendimin që “Lidhja e Shkrimtarëve dhe Artistëve shqiptar “Papa klementi XI. Albani”, pranoi “Anëtar nderi”, studiuesin e njohur z. Nuri Dragoj dhe Profesorin e shkencave sociale z. Zydi Dervishi, të cilët iu bashkuan listës së gjatë të emrave të pranuar më parë, ku mes të tjerëve janë edhe Murat Gecaj e Viron Kona nga Tirana dhe Flora Dervishi nga Durrësi”.

b. Pak dit pas kësaj ngjarje të bukur, në mesgusht 2017, një tjetër udhëtim edhe më i këndshëm drejt qytetit të Mitrovicës, ku u pritëm nga nikoqirët z. Hysen Ibrahim, kryetar i Lidhjes së shkrimtarëve dhe artistëve shqiptar “Papa Klementi XI-Albani”, në Suedi dhe z. Bajram Muharremi-Bistrice, nënkryetar. Të dy bij Dardanie nga Drenica, banues në Suedi. Mes nesh ishte edhe Nuriu. U lumturua, pasi përmbushëm një ëndërr, sepse asnjëri nga ne nuk e kishte parë këtë qytet shqiptar me shumë histori të trazuar. Këtë herë në timon ishte profesor Zydi Dervishi. Fjala u kënaqëm është shumë e vakët për të shprehur ndjesinë që përjetuam, jo vetëm nga mikpritja tradicionale shqiptare. Këto i shprehëm edhe në fjalën tonë në TV. lokal “Mitrovica”, që u transmetua po atë mbrëmje nga gazetari Fazli Muharremi-Tali.

Plot kureshtje vizituam qytetin. E shkelëm dhe e kaluam edhe urën mbi lumin e Ibrit, që ndan në mes Mitrovicën dardane. Bëmë fotografi pranë shtatores së Isa Boletinit. Në të tilla raste të përfshin frymëzimi, ndaj shkrova:

“Mitrovicë e bukur, pse mbetesh e ndarë/ Veriu me serbë, jugu me shqip-



Dr. Nuri Dragoj



Nga e majta: Fazli Muharremi, Kadri Tarelli, Nuri Dragoj, Zydi Dervishi e Viron Kona, Mitrovicë, 2017

tarë?/ I bri shkon në mes, me këngën e vrarë/Nuk e dimë ç’ thotë, kur tërhiqet zvarrë!”. (Kadri Tarelli. Libri: Koha në vargje”. Poezia: “Mitrovicë dardane! Largoji ato rel”).

Nuriu, me një karrierë të gjatë si gazetar profesionist, ka filluar që me gazetën “Zëri i Popullit” dhe më pas në shumë organe shtypi. Ka qenë kryeredaktor i gazetës “Republika”, punonjës në Institutin e Historisë, kryeredaktor dhe botues i gazetës “Dëshnica”. Është autor i shumë librave të karakterit studimor-historikë, monografi personalitetesh të nderuar, si luftëtarë, dijetarë, atdhetarë e letrarë, etj, etj.

Pjesa më e madhe e librave i kushtohet historisë së kombit Shqiptar, si problem i pa zgjidhur përfundimisht, i mbetur nën kërcënimin e vazhdueshëm të fqinjëve lakmitarë dhe dallaveve që bëjnë kancelaritë e huaja.

Mjaftojnë këto pak fjalë për të kuptuar të gjithë mendimin e tij shkencor, historik, letrar dhe filozofik, mbi kombin dhe shtetin shqiptar dhe gjendjen në të cilën ishte, është, dhe po vazhdon të ndodhet edhe në ditët sotme: “Në të gjitha momentet e ekzistencës së vet, Shqipëria i ngjante një fëmije, të cilin e rrihnin çdo ditë, por nuk e linin të qante. Edhe në çastin kur po bëhej gati të fliste, fqinjët po përgatiteshin t’i prisnin gjuhën, mbase edhe kokën”. Nuri Dragoj. “Prapaskenat e Konferencës së Londrës”. Diku edhe pyet me dhimbje: “A ka strategji kombëtare, për zgjidhjen e çështjes shqiptare? Pyetje që shpon plagën e hershme. Heshtja është tragjike, sepse dhemb akoma më shumë sot, kur kemi shtetin tonë dhe shohim e dëgjojmë se ç’ pazare bëhen.

Një thënie Rusoit të ndritur na rrëfen: “Shkalla e vlerës së një libri,

varet jo vetëm nga fakti se sa të emocionon, por edhe sa të bën të mendohesh”. Ndërsa unë shtoj pa modest, se kur libri të frymëzon është më shumë se kaq: është mrekulli dhe ka brenda madhësi. E them këtë se librit “Prapaskenat e Konferencës së Londrës”, pasi e lexova, i kushtova shkrimin: “Një libër që nuk pata guxim ta çoj deri në fund”. “Prapaskenat e konferencës së Londrës”. Autor Nuri Dragoj. Shkrim që u publikua: “Fjala e lire”. Londër, më: 29. 06. 2018. Gazeta “Durrësi Bulevard”. 29. 06. 2018, edhe në disa portale të tjerë. Më pas vazhdova edhe me një poezi që ka titull ngacmues: “Europa e prish pazarë, sa kohë jemi të përçarë”. Kadri Tarelli. Libri: “Koha në vargje”.

Lidhur me librin dhe shkrimet për të, akademik Eshref Ymeri, anëtar i Akademisë shkencore-letrare, shqiptaro-Amerikane me seli në Neë York, shprehet: “lexova analizën mjaft serioze të librit “Prapaskenat e Konferencës së Londrës”, me autor studiuesin e mirënjohur dr. Nuri Dragoj, një intelektual ky me formim të admirueshëm nacionalist”.

Ndërsa Bashkim Saliasi shkruan: “Në javën e trete të shtatorit 2020, Nuriu më dhuroi dy libra të botuara kohët e fundit: “Dhimbje shqiptare”, (Skica dhe ngjarje historike), dhe “Njerëz të pushkës dhe të penës”. Është kënaqësi t’i kesh në bibliotekë dhe, kur ke nevojë të njohësh më shumë për ngjarjet historike, ke se çfarë mëson”.

Bashkimi nuk e dinte se ç’do të ndodhte pak dit më pas. Kështu me fjalë zemre e uron: “Urime miku im Dr. Nuri Dragoj dhe suksese në punën tuaj krijuese dhe studiuese. Të uroj

shëndet dhe qofshi mirë nga hera familjarisht dhe sa më shumë krijime të tjera të bukura letrare artistike dhe studime me vlera historike. Respekte”. (Revista “Dituria”. Suedi. Shkrimi “Një jetë kushtuar gazetarisë, studimeve historike dhe letërsisë”. 15. 10. 2020).

Sejdo Harka, i drejtohet: “Ti Dr. Nuri Dragoj do të mbetesh në zemrat tona modeli i njeriut modest, që nuk dije të mburreshe, por me thjeshtësinë dhe dashamirësinë që të karakterizonte, i dhe shoqërisë vlera me studimet e tua historike”.

Viron Kona, ngushëllon: “Nuriu e ka dashur shumë Atdheun, ndaj i ka kushtuar asaj dhe mbrojtjes së interesave kombëtare, energjitë e jetës së tij, të shpalosura në vepra me vlera të mëdha, të cilat kombi shqiptarë do t’i ruaj si margaritarë të rrallë të dijes dhe të shprehjes së patriotizmit të zjarhtë. Mesazh ngushëllimi drejtuar familjes.

Kujtim Mateli: Redaksia e gazetës “Dëshnica”: “Jeta e Nuri Dragojt ka qenë një përpjekje e pamposhtur për të thënë të vërtetën, për padrejtësitë që i janë bërë Shqipërisë, përgjatë gjithë historisë së saj. Ky përkushtim e nxiti që të studiojë historinë e Shqipërisë dhe të mbronte doktoraturën në histori. Aq sa ishte një shkencëtar në fushë të studimeve historike, të tillë lartësi krijoi edhe si atdhetar i vërtetë. Nuriu, gjatë gjithë këtyre viteve të fundit, ndjehej i shqetësuar se nën agresivitetin e fqinjëve po rrudhej dimensionin shpirtëror i shqiptarëve.....”.

Nuri Dragoj nuk është më mes nesh. Me keqardhje po sjell në kujtesë një telefonatë, bërë aty nga fundi muajit shtator 2020, ku Ai, pasi më pyeti për shëndetin, më njoftonte, se kishte dëshirë të më dhuronte dy libra e tij të fundit. Unë ju shpreha: “Koha është e vështirë. Dy rrugë ka: ose të vi unë në Tiranë, ose të vish ti në Durrës. Dëgjova të qeshurën në telefon, ndaj vazhdova: Kam qejf të vish ti në Durrës, se edhe unë kam botuar një libër të ri”. Por nuk qe e thënë të takoheshim më! Ishte hera e fundit që i dëgjoja zërin. Do të na mungojë gjatë fizikisht.

Nuriu prehet në parajsë, duke lënë pas veprat e tij me vlera shkencore dhe atdhetare. Ato janë monument që ai i ngriti vetes, për të mbetur në përjetësi. Kështu do të jetë përherë i gjallë mes nesh dhe krejt shqiptarëve, duke i dhënë të drejtë të diturit Moikom Zeqo, që na ka lënë ca fjalë të arta:

“Kur një krijues ndahet nga jeta, mbyllet një portë, por ai le me dhjetëra të tjera, që do të hapen nga brezat në përjetësi”.

Si u arrit çlirimi i Iballës 76 vjet më parë

(Vijon nga faqja 8)

kthim për Iballë për më shpejt ke kaluar sipër Shkambit të Çllumit të Merturit (1400 m lartësi mbi dy anët e Drinit) nëpër një shtek thepash gursh curri, që mbi 10 m gjatësi, nuk ishte as më 5 cm i gjërë, kur pate shkuar për të parë atje faqe Shkambit: “Shkrojlal e Turkut!”, ndërsa në Kryezi të priste bashkëshortja, mësuëse Nexhi me dy fëmijët e mitur, kurse ti si pelivan majë Shkambit me Lekë Hajdarin, mësues i Apripës aso kohe. ! Kaq mjafton për sa kisha dëshirë ta jepja këtë porosi, se qejfi ma do me të pa majë ksi lartësish suksesesh, por pa rrezik jete, se boll


kanë gjuajt edhe në ty, për biografinë e dajës tand, Abdullah Salihin, I dënuar politik, i cili ka qenë burrë i vërtetë për kohën !”

Për sa sipër rasti e solli ta kujtojmë të ndjerin e të nderuarin Man Avdi Arifin me këtë shkrim modest, në kuadrin e 100-vjetorit të ditëlindjes së Tij, 1920 – 2020 dhe 76 – vjetorit të çlirimit, më 6 nëntor 1944- 2020 nga pushtimi nazifashist të Iballës së Pukës, fshat, ku kam shërbyer dy vjet (1957- 1959) zv/drejtor e drejtor i Shkollës 7-vjeçare Iballë me filloret e Brigjeve të Drinit, që nga Brebullat, Mertur-Guri dhe deri në Mëzi, ku mbijetonte një popull kreshnik alpin.



PËRKUJTIMORE

Vërtet ne kemi
Bajram e Pashkë,
por Shqiptarinë
e kemi bashkë.



Naim Frashëri
1846-1900

“Nata e bardhë Naimiane”, homazh me rastin e 120-vjetorit të ndarjes nga jeta të Naim Frashërit

Naim Frashëri dhe At' Gjergj Fishta, poetë kombëtarë të pandarë

Muharem Kamani

Shoqata Atdhetare Kulturore Mbarëkombëtare “Vëllezërit Frashëri”, me mbështetjen e Ministrisë së Kulturës dhe Bashkisë Përmet, organizoi veprimtarinë përkujtimore: “Nata e bardhë Naimiane”, homazh me rastin e 120-vjetorit të ndarjes nga jeta të Naim Frashërit dhe 149-vjetorit të lindjes së Gjergj Fishtës në Qendrën Kulturore Multifunkionale “Odise Paskali”. Nga personalitetet e pranishme u bënë homazhe dhe u vendosën kurora me lule nga Bashkia Përmet, Prefektura, Deputetja, Këshilli i Qarkut Gjirokastrë, Këshilli Bashkiak Përmet dhe Shoqata “Vëllezërit Frashëri” pranë bustit të Naim Frashërit.

Nderuan me pjesëmarrjen e tyre Kryetarja e Bashkisë Alma Hoxha, Deputetja Mirela Kumbaro, Kryetare e Këshillit të Qarkut Gjirokastrë Lindita Rova, Kryetari i SHAK “Vëllezërit Frashëri” Tomor Kotori, Kryetari i KSHA “Naim Frashëri” Ligor Shyti, Kryetari i SHAK “Përmeti” Kastriot Bezati, publicistë, gazetarë, artistë etj.

Fjalën e mirëseardhjes dhe përshëndetese në këtë veprimtari homazh e konceptuar si konferencë shkencore dhe recital poetik e mbajti Tomor Kotori, i cili uroj mirëseardhjen në këtë veprimtari dhe zhvillimin e saj me sukses. Midis të tjerash tha: Kjo veprimtari jubilarë që organizon shoqata jonë në vite me ish komunën Frashër dhe bashkinë Përmet është e 19 – ta qysh nga viti 2002 e deri më sot. Kjo traditë duhet të ruhet me mbështetjen e institucioneve shtetërore. Më tej ai foli për jetën dhe veprimtarinë krijuese të poetëve kombëtar Naim Frashëri e At Gjergj Fishta.

Historian Kastriot Bezati “Mjeshtër i Madh” referoj kumtesën: “Vëllezërit Frashëri në veprën e Gjergj Fishtës”. Ai midis të tjerash theksoj: “Abdyli, Naimi e Samiu shkrinë në një të vetme tre detyrat themelore taktike që shtroheshin para vendit: së pari, shpëtimin e atdheut nga gjymtimi territorial. Së dyti: bashkimi e viseve shqiptare në një vilajet autonom dhe së treti lëvizimin e kulturës atdhetare në shërbim të lirishtit të Shqipërisë.

At' Gjergj Fishta në veprën e tij madhore “Lahuta e Malsisë” ngre lart figurat e



Abdyl Frashërit, atdhetarit, udhëheqësit, burrit të shtetit, ideologut, politikanit, organizatorit dhe veprimtarit të shquar të LSHP. Gjergj Fishta për Abdyl Frashërin ndër të tjera thotë: \ Abdyl Frashëri i la nam toskërisë, \ dhe \faqe të bardhë i la Shqipërisë\.

Poeti Lumo Kolleshi në kumtesën e tij bëri një analizë tekstuale të një sythi nga bukuria e Naim Frashërit. Poetët e vërtetë lindin e bëhen diell. Në një takim që bëri me krijuesit përmetarë më 03 dhejtor 1998 Dritëro Agolli tha: “Naim Frashëri ishte ëngjëllor i veshur me kostum popullor dhe pa kobure në brez”.

Mirela Kumbaro përshëndeti përzemërsisht të pranishmit, poetët dhe vlerësoj nivelin e lartë të kumtesave të mbajtura e shprehu konsiderata për drejtuesit e shoqatës veprimtaritë e së cilës tashmë janë bërë traditë. Fëmijët e Lezhës recitojnë Naimin dhe ata të Përmetit Fishtën. Kam qënë pjesë e këtyre veprimtarive edukative dhe mbresëlënëse.

Në emër të institucionit të Bashkisë Përmet përshëndeti Kryetarja Alma Hoxha e cila midis të tjerash tha: “Është kënaqësi të jem pjesë e kësaj veprimtarie kushtuar dy poetëve kombëtar. Edhe sot nga distanca kohore i përkujtojmë si burim ideali, vullneti dhe veprimtar që ditën të shtrojnë dhe sintetizojnë prespektivën dhe objektiven, realen dhe të mundshmen, qëndresën dhe përpjekjen, fitoren dhe urtësinë. Vdekja e Naimit dhe ditëlindja e Fishtës, janë si të vendosura me dorë nga atësia dhe zoti pranë njëra-tjetrës. Janë si dy krenat e shqiptonjës për gjuhën tone, njëri gegë e tjetri toskë. Dy emra të mëdhenj me sta-

tus të padiskutueshëm mbarëkombëtar, dy emra monumentesh mendor me fuqi rrezatuese të pashterueshme, çlirues energjish të brendshme në pafundësi. Naimi dhe Fishta janë misionar të pavdekshëm, ata janë kombëndriçuesit tanë. Sa bukur kur je në vendin e Naimit, sa bukur kur ke dhe Fishtën në vendin e Naimit”.

Në emër të Këshillit të Qarkut Gjirokastrë Lindita Rova bëri përshëndetjen e saj dhe e mbylli me vargjet e poetit Petrit Ruka” Mjeshtër i Madh”, elegji “Varrimet e Naimit”.

Paulin Zefi vlerësoj këtë veprimtari mbresëlënëse, emocionuese, dhe me vlera të gjithanshme edukative për brezin e ri, pasi vepra e Naimit e Gjergj Fishtës janë gurë të rëndë në themelet e kombit shqiptar. Naimit i është ngritur monument, Fishta ka qënë i harruar e ndaluar. Para një jave inaguruan shtëpinë në fshatin Fishtë. Të afërmit ruajnë kopjen origjinale të “Lahutës së Malsisë”. Detyra jonë ta pajisim me dokumenta dhe të bëhet e vizitueshme në përvjetorin e 80 të vdekjes dhe 150-vjetorin e lindjes së tij e të bëjmë veprimtari të ndërsjellta çdo vit në Lezhë e Përmet.

Nuri Çuni duke përshëndetur informoj me veprimtaritë qysh nga 10 korriku 2020- 25 maj 2021 në 175 –vjetorin e lindjes në Frashër. Ekspozita e lëvizshme me 115 stenda përgatitur nga shtëpia botuese LMG nga botuesi dhe studiuesi Mehmet Gëzhilli e cila do qarkullojë në hapësirën mbarëkombëtare dhe në disa qytete. Ai u ndal dhe vlerësoj lart dekorimin e vëllezërve Frashëri me Urdhrin e Flamurit Kombëtar nga Presidenti i Republikës.

Zaho Golemi falënderoj organizatorët

dhe vlerësoj Naimin si intelektual i kalibrit botëror. Në vitin 1886 u botuan 6 veprat e tij në Bukuresht. Mua më kanë lënë mbresa kur shërbeja në Himarë dëgjova në Pilur këngën e grupit me tekst të Lefte Çipës “ Bilbil i vendeve të mia”... \More Naim Shqipëria\ . Kur isha në akademinë e sigurisë në Stamboll takova një nënë shqiptare që qante dy djemtë që prehen në Shqipëri dhe një në Stamboll.

Viktor Gjokolaj solli në kujtesë veprimtarinë vjet në Lezhë ku nxënësit e gjimnazit “Hydajet Lezha” e “Sami eFrashëri” Përmet me poetin Lumo Kolleshi , recituan vargje të Naimit dhe të Fishtës. Përpjekjet tona veprën e tyre tua transmetojmë të rinjve dhe recitoj poezinë e Çajupit për Naim Frashërin.

Tomor Kotori shpërndau titujt e nderit për Hysen Berishën e Albert Z. Zholi: “Nderi i SHAK Mbarëkombëtare Vëllezërit Frashëri”.

Bekim Kelmendi recitoj “Atdheu” të Naimit e Fishtës. Kam ardhur 14 vjet rresht nga Rahoveci i Kosovës dhe do vij për çdo vit.

Recitalin poetik e drejtoj poeti Lumo Kolleshi. Recituan poezitë e Naimit nxënësit nga Lezha: Rosela Manshi, Rigers Dedëndreaj, Xhiliberto Gega, Aurela Misuli, përgatitur me nivel të lartë artistic nga mësuesja e letërsisë Ana Pali. Gjeniu i vogël Nikoll Prendi recitoj poemën “Bagëti e Bujqësi” të Naimit.

Nxënësit e shkollës “Meleq Gosnishi” Estrieri Milo, Pamela Pashollari, Ordilda Jeon Mile, Elda Nasto, Aleksandra Qendro recituan poezi nga veprat e Naimit përgatitur nga mësuesja Kozeta Jashari.

Nxënësit e shkollës “Sami Frashëri” Ester Shkurta, Marina Çuedari, Esmeraldo Metko, Katerina Todhe, Goljano ilias interpretuan pjesë nga Lahuta e Malsisë.

Në darkën e shtruar për nder të të ftuarve te lokal “Nemërçka” recituan poetët Nikoll Prendi, Sami Vëlçani, Muharem Kamani, Viktor Gjokolaj, Hysen Berisha, Haxhi Kalluci, Salvator Gjeçi dhe e mbylli Lumo Kolleshi. Poetët dhuruan libra.

Mirupafshim më 30 dhjetor 2020 në 80-vjetorin e Fishtës dhe më 25 maj në Frashër në 175-vjetorin e lindjes së Naimit dhe 23 tetor në Lezhë në 150- vjetorin e lindjes së Gjergj Fishtës.

REPORTAZH

“MIRËSEERDHËT NË IBALLË”, në këtë zonë që të ngjan me ndonjë rajon në Zvicër apo Suedi



Kol DEDAJ

Bashkia Fushë-Arrëz, në bashkëpunim dhe me mbështetjen e financimit biznesmenit të njohur Lazër Mëhilli organizuan inagurimin e bujtinës “Guest house Vila L”, në Iballë të rrethit Pukë.

Zona e viseve Berishë e Iballë, e cila në mesjeten e herëshme njihet si “Dheu i Eperm”, apo më vonë si “Ana e Eperme” është një ndër më të vjetrat e të lavdishmet. Iballa në vetëvetë është e populluar kryesisht nga fisi Thaçi, por dhe të tjerë. Fisi Thaçi dhe toponimi “Thaç” na dalin në pah që në periudhën e Princ Lorikut, i cili ka jetuar 300-400 vjet para Krishtit (Kadrush Sulejmani, “Udhëtimet e Princ Lorikut të Dardanisë, Për Besëlidhjen e Fiseve dhe viseve Ilire” fq.34).

Për të marrë pjesë në këtë event u nisëm herët në mëngjes nga Tirana dhe ndalesën e parë e bëmë në Qaf/ Ballshit, teksa natyra të jepte bukuri mbresëlënëse. Më tej vazhduam udhëtimin për në Qaf/ Shari prej ku përpara të shfaqej një pamje magjepsë e Fushës së Iballës me lumin Iballë që e përshkruante atë dhe përballë “Qafa e Kryqa Malit” e rruga e makinës që të çon për në Berishë, tek kjo amëz e fiseve shqiptare, e më tej Mertur e Bugjon. Ndërsa në Juglindje, mali i Krrabit dhe “Qafa e Vukazit”, ku rrezet e diellit thyheshin në ujin e liqenit të Iballës. Në Jug shkelqente Mali i Balës dhe nga Veriu “Qafa e Hysen Markut” dhe mali i “Shullajës”. E gjithë kjo krijon një ansambël të tërë të mrekulueshëm, me lumenj, liqene, fusha, kodra si një amfiteatër i stolisur natyral. Bukuri e cila shtohet kur shikoje shtëpi dhe kulla me çati të pjerrta alpine, rrugë të asfaltuara, të vijëzuara e ku tabela të thoshte “MIRËSEERDHËT NË IBALLË”, në këtë zonë që të ngjan me ndonjë rajon në Zvicër apo Suedi. Aq bukur e përshkruan këtë treve në vargje Dr. Gjeshi NIKOLLA - studiues: “Jam e lashtë sa vetë lashtësia / Vij dhuratë nga perëndia / Kam rritë breza legjendar / Para krishtit kam shkriar / Kam shkriar, kam shkriar argjend / Para atdheut nuk vë as kënd” (Gazeta Telegraf, datë 21.02.2018, f.18).

Në ambjentet e Bujtinës “Guest house Vila L” na priti Lazër Mëhilli, i cili na uroi mirëseardhjen. Atmosfera ishte festive. Kishin mbërritur personalitete të pushtetit lokal: Fran Tuci-Kryetari i Bashkisë Fushë-Arrëz, Gjovalin Alia-Kryetari i Shoqatës së Ekoturizmit Pukjan; Lazër Mëhilli-Intelektual dhe biznesmen; Tonin Alia (Mjeshtër i Madh) dhe biznesmeni i mirënjohur me kopaninë e tij “Ardeno”, të shtrirë në Ballkanin perëndimor dhe Itali; Mark Gjini-biznesmen i mirënjohur me kompaninë e tij “Rafaelo 2002” Sh.a me shtrirje në disa vende të rajonit, intelektual Dedë Maluta - ndër të parët biznesmenë në Pukë dhe vend, Dr. Arjan Starova – President i Këshillit Atlantik të Shqipërisë dhe Kryetar i BLD, Bashkim Hoxha (Mjeshtër

VLERAT DHE RESURSET E ZONAVE BERISHË DHE IBALLË

- Në programin e kësaj dite, veç promovimit të vlerave dhe resurseve të kësaj treve, ishte edhe akordimi i titullit: “Qytetar Nderit” që Bashkia Fushë-Arrëz i ka dhënë, poetit, prozatorit, shkrimtarit, studiuesit Ton ZMALI, çertifikatë të cilën në mungesë të z. Ton Zmali në pamundësi të mberitjes nga Greqia, ju dorezua familjarëve të tij nga shkrimtari dhe publicisti i mirënjohur Bashkim Hoxha - Mjeshtër i Madh



"Guest house Vila L" Iballë, foto 2020

i Madh), Av. Marash Ibraj, vëllezërit Zef dhe Dode Luli, Ndue Maluta, Av. Lin Alia, Simon Mirakaj, Sokol Mirakaj, studiuesit Luigi Martini, Gjeshi Nikolla, Gjergj Alia, etj., si dhe mysafir të shumtë nga të katër anët, miq, shokë dashamirës e të afërm të Lazrit, nga zonat përreth, nga Puka, Tirana, Mirdita, Shkodra, Lezha, Kukësi, Tropoja, etj.

Iballa është simbol i arsimit, dijes e kulturës për të gjithë rrethin e Pukës e më gjërë. Dikur në Iballë ziente jeta artistike dhe kulturore. Kulmin e zhvillimit në art dhe kulturë zona e Iballës e njohu gjatë viteve kur Vatrën e kulturës e drejtonte një regjisor i ri, plot energji, pasion, ide e ëndërra për jetën, poeti i shquar e prozatori i rrallë Ton Zmali nga fshati Kokdodë. Dhjetë vite jetë, vitet më të arta Ton Zmali ia kushtoi Iballës. Ishte koha kur trupa teatrale amatore vinte në skenë si profesioniste të vertete dramat “Cuca e Maleve”, “Baca i Gjetajve”, si dhe dhjetra e dhjetra koncerte artistike e kulturore të denja për skenën kombëtare. I diplomuar në Akademinë e Arteve të Bukura në Tiranë, Ai ka punuar si mësues në viset e Pukës dhe të Lushnjës. Si shkrimtar dhe poet i apasionuar, Ai është autor i disa romaneve dhe botimeve poetike. Është fitues i çmimit të parë në konkursin e poezisë në qytetin e Selanikut (Greqi) me librin poetik “Lulet e Ksenit”. Në vitin 1978, në kuadër të 70-vjetorit të shpalljes së pavarësisë, në

Pukë u organizua sesioni shkencor me temë: Mbi traditat patriotike të popullit tonë. Në këtë simpozium studiuesi Ton Zmali mbajti kumtesën; Ndoc Mark Deda dhe veprimtaria e tij patriotike, të cilën Seksioni i Arsimit dhe Kulturës dhe kabinetit pedagogjik i rrethit Pukë e botoi në librin “PUKA dhe SHKOLLA - V”, (Pukë, 1978, f.65-67). Arritjet e tij në fushën e letrave shqipe e kanë përfshirë atë në dy antologji të mëdha poetike të emigracionit “Qiejtë e shpirtit” dhe “Itaka e Fjalës”. Prej vitesh jeton, punon dhe krijon në Athinë të Greqisë. Në programin e kësaj dite, veç promovimit të vlerave dhe resurseve të kësaj treve, ishte edhe akordimi i titullit: “Qytetar Nderit” që Bashkia Fushë-Arrëz i ka dhënë, poetit, prozatorit, shkrimtarit, studiuesit Ton ZMALI, çertifikatë të cilën në mungesë të z. Ton Zmali në pamundësi të mberitjes nga Greqia, ju dorezua familjarëve të tij nga shkrimtari, gazetari dhe publicisti i mirënjohur Bashkim Hoxha (Mjeshtër i Madh).

Ndërsa nipi i Lazrit, Gëzim Mhilli shoqëronte një grup mysafirësh tek godina dy katëshe përballë, Lazri na shoqëronte neve, duke vizituar ambjentet e godinës kryesore trekatëshe. Në katin nën tokë gjendej kaldaj, dhoma frigoriferike si dhe ambjentet e tjera teknike e ndimëse, në katin e parë (përdhe) gjendej oda (dhoma) e madhe me sipërfaqe rreth 50m2 dhe ambjentet e tjera pritëse për mysafirët.

Në katin e dytë dhe të tretë gjendeshin 8 (tetë) dhoma fjetje, secila me tualet dhe një mobilim estetik dhe funksional. E gjithë godina të ngjante me një kështjellë, e ndërtuar me beton-arme dhe me mura-turë guri dekorativ dhe materiale të tjera importi. Një ndalesë të veçantë bëmë në dhomën muze, ku jepej ecuria jetësore e kësaj familje fisnike me të parin e saj, Pal Qamluk Mhilli, i cili nga martesja e tij me Line Mhill Mhilli, bijë Berishe në derën e Zef Mhill Metës nga Papi, sollën në jetë gjashtë fëmijë, tre vajza: Zepja, Terezja, Dranja dhe tre djem Pjetrin, Nikollën dhe Lazrin. Në vitin 1990-’91 Lazri punoj si llogaritar në kooperativen bujqësore Iballë, në vitin 1991-’94 si ekonomist dhe më vonë si drejtor i ndërmarrjes së prodhimeve pyjore Fushë-Arrëz; në vitin 1994-’96 punoi si drejtor i Bankës Tregtare Agrare dega Pukë, në vitin 1996-’98 si specialist pranë bankës kombëtare tregëtare Tiranë si dhe u transferua familjarisht në Tiranë. Në viti 1988 pas paisjes me licensat profesionale hapi biznesin e tij privat, zyrën kontabiliteti me disa të punësuar. Në vitin 2002 Lazri e zgjeroi aktivitetin me krijimin e Shoqërisë së Ndërtimit “Vila L” shpk, me aktivitet kryesor ndërtimin e godinave shumëkatëshe të banimit, duke qenë ndër shoqëritë më të sukseshme në vend dhe me shtrirje në Shqipëri, në Podgoricë të Malit të Zi e më gjërë.

(Vijon nr. e ardhshëm)

PROMOVINI

Dhjetra personalitete të letrave e të shkencës, në promovimin e librit të shkrimtarit e gazetarit të dekoruar me Titullin “Mjeshtër i Madh”

60-vjetori i ditëlindjes, Presidenti Meta në promovimin e librit të 17-të të Halil Ramës

(Vijon nga faqja 7)



Luljeta Prençi-Dishi: Testament i vyer historiko-kulturor



Znj. Luljeta Prençi-Dishi (Drejtoreshë e gjimnazit “Ibrahim Rugova” Kamëz) ka ndarë me qindra pjesëmarrës në këtë promovim, përjetimet si redaktore e librit, me bindjen të ketë përmbushur pritshmeritë e H. Ramës, lidhur me cilësinë e redaktimit në përputhje me llojin e tekstit (letërsi doku-

mentare). Ajo falenderoi autorin i cili i dha mundësinë ta shfrytëzojë kohën e izolimit në mënyrën më të mirë të mundshme, pikërisht duke redaktuar këtë libër të rëndësishëm, që lartëson vlerat e Muhurrit dhe të muhurrakëve, vlerat e zonës nga ajo vjen dhe ku kaloi fëmijërinë dhe rininë e saj. Gjatë redaktimit të librit, ajo pohoi se është njohur më nga afër me historinë e lavdishme të zonës së Muhurrit si dhe me kontributin e vyer të sa e sa personaliteteve historike apo aktualë të asaj zone, të cilët na bëjnë krenarë ne sot.

Nisur nga fakti se se secili nga ne, me punën dhe përkushtimin e vet, jep një kontribut të zakonshëm ose të jashtëzakonshëm gjatë jetës, e megjithatë jemi të përkohshëm në këtë botë, redaktorja Prençi-Dishi tha se: “Falë njerëzve të tillë si Halil Rama, që lartësojnë vlerat tona, kontributi ynë për zonën dhe për shoqërinë mbetet si një testament për brezat”. E në këtë kuptim, ajo e konsideroi librin “Muhurri, histori dhe personalitete” një “Testament të vyer historiko-kulturor” në dorën e muhurrakëve dhe jo vetëm....



Dr. Hajri Mandri: Dukuri estetike të libri i Halil Ramës



Në vlerësin e dr. Hajri Mandrit: “Përjetimi estetik i jetës në mënyrë sa më intensive është synimi suprem i njeriut. Kështu, kur lexojmë këtë libër të Halil Ramës, dukuria estetike që shkakton leximi i tij, ka të bëjë me ndjenjën e të bukurës dhe kënaqësisë estetike që të krijon. Pasioni, malli, adhurimi e dashuria që autori derdh në të e ka bazën në vlerësimi që ai ka për traditat si mikpritja bujaria, trimëria, zgjuarsia, humaniteti që evokojnë krenarinë për vendlindjen, si substancë e krenarisë kombëtare.

Jeta politiko-shoqërore e banorëve muhurrakë në mënyrë konvencionale na jepet me intelektualët e zonës duke i vendosur në kohë shembëllojnë si gurë kilometrikë në libër që lajmërojnë kohën, mendësinë, psikologjinë, dhe ideologjinë e kohës që përfaqësojnë dhe habitatit ku kontribuojnë.

Dashuria për vendlindjen jepet me një optimizëm të trëndafiltë. Përmes figurave të përzgjedhura me kujdes krijojnë një vatër estetike si mirënjohje për punën, përkush-

timin, ndershmërinë, zgjuarsinë, bujarinë, humanizmin mikpritjen komunikimin elitare, të ëmbël e të këndshëm. Në këtë libër, mbi doktrinat që na ndajnë është dashuria për kombin. Gjejmë ën të larmi imazhesh, idesh dhe personazhesh të venë në lëvizje imagjinatën dhe përfytyrimin estetik drejt vlerave morale dhe humane. Mjafton shembëllimi për të mbërritur intuitivisht te thelbi.

Halil Rama ka zgjedhur një procedim të dobishëm për lexuesin. Pasi vë kuotat historiko-kulturore autori përmes personazheve realë, lundron nga një periudhë në tjetrën duke identifikuar si xixëllonjat në fusha, personazhet realë që drejtuan dhe krijuan raporte me vlera morale e shoqërore e që kanë lënë gjurmë tek pasardhësit që duke i kujtuar krijojnë kënaqësi estetike, si ndjenjë e të bukurës që vjen nga rrëfimi”. Dr. Hajri Mandri tha se autori Halil Rama e mbyll librin me figura aktuale nga zona a tij që kontribuojnë në ndërtimin e demokracisë liberale si mishërim i vlerave të shoqërisë që jetojmë.